



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

**RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE
PËR VITIN 2019**

TË KRU BIFURKACIONI SH.A.

Prishtinë, qershor 2020

1 RAPORTI I AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM

Për: Komisionin Komunal të Aksionarëve

Bordin e Drejtorëve të KRU Bifurkacioni sh.a.

Kryeshefin Ekzekutiv – z. Xhabir Morina

Zyrtarin Kryesor të Financave dhe Thesarit – z. Valon Sadiku

Adresa: Rruga Enver Topalli, 45, Ferizaj

1.1 Opinioni i auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të KRU Bifurkacioni sh.a.

Ne kemi kryer auditimin e Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) të Kompanisë Rajonale të Ujërave (KRU) Bifurkacioni sh.a., të cilat përfshijnë pasqyrën e pozitës financiare për vitin 2019, pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e rrjedhës së parasë së gatshme, pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet, shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme kontabël.

Në vijim është Opinioni i Auditorit të Përgjithshëm:

Opinion i kundërt

Sipas opinionit tonë, për shkak të efekteve të çështjes së përshkruar në paragrafin “Baza për Opinion të Kundërt”, Pasqyrat Financiare të bashkangjitura nuk paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të pozitës financiare të KRU Bifurkacioni sh.a., deri me 31 dhjetor 2019, të performancës së saj financiare, si dhe rrjedhës së parasë së gatshme për vitin 2019, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF). Transaksionet nuk janë kryer në pajtim me rregullat dhe rregulloret financiare të aplikueshme për ndërmarrjet publike.

Baza për opinion të kundërt

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë te pjesa e raportit “Përgjegjësitë e Auditorit të përgjithshëm për Auditimin e Pasqyrave Financiare”. Në përputhje me ONISA-P-10 dhe SNISA 130, si dhe me kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të Ndërmarrjeve Publike dhe Kodin e Etikës të ZKA-së, ZKA-ja është e pavarur nga Ndërmarrja Publike KRU Bifurkacioni sh.a. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

- Sipas Standardit Ndërkombëtar të Kontabilitetit - SNK 16, rivlerësimet e pasurive duhet të bëhen në mënyrë të rregullt çdo tri ose pesë vite, që të sigurohet se vlera kontabël (neto) e aktivitet nuk ndryshon materialisht nga ajo që do të përcaktohej nëse do të përdorej vlera e drejtë në fund të periudhës raportuese.

Kompania procesin e vlerësimit të asetëve për herë të fundit e kishte realizuar në vitin 2007. Si rezultat i kësaj në regjistrin kontabël të asetëve, figurojnë një numër asetesh (444 sosh), me kosto të përvetësimit në shumën 897,767€, e që janë të zhvlerësuara në tërësi dhe të regjistruara me vlera zero. Këto pasuri janë ende aktive dhe për të njëjtat, nuk ishte bërë ri vlerësimi dhe rishikimi i jetëgjatësisë së tyre.

Çështja e rivlerësimit të asetëve, është trajtuar edhe në raportin e auditimit financiar për vitin 2018, mirëpo sipas zyrtarëve të Kompanisë, mungesa e burimeve financiare dhe afarizmi me humbje kanë ndikuar në mos marrjen e veprimeve për një procedurë të tillë.

- Sipas Standardit Ndërkombëtar të Kontabilitetit - SNK16, në lidhje me amortizimin e aktiveve në mes tjerash kërkon që shuma e amortizueshme e një aktivi të shpërndahet mbi baza sistematike gjatë jetës së tij të dobishme dhe amortizimi ndërpritet kur aktivi është plotësisht i amortizuar.

Duke u bazuar në politikat e zbatuara të zhvlerësimit të Kompanisë, ne kemi kryer ri llogaritjen zhvlerësimit sipas grupeve dhe normave të zhvlerësimit për të cilat vijmë në përfundim se shpenzimet e zhvlerësimit janë nënvlerësuar për 8,721€. Ky nënvlerësim ka ndikim në pasuritë neto, fitimin/ humbjen dhe fitimet e mbajtura të Kompanisë.

- Llogaria “Tatimi i Vlerës së Shtuar (TVSH) e pagueshme” është llogari e detyrimeve. Me tepicën kreditore të kësaj llogarie, tregohet detyrimi i papaguar ndaj shtetit për TVSH-në. Në bilanc, ajo prezantohet në seksionin e detyrimeve afatshkurtra.

Kompania, detyrimet për TVSH i kishte prezantuar në shumën 396,392€. Mirëpo, analizat tona të bëra bazuar në “Deklaratat tatimore”, “Gjendjen e përgjithshme të deklarimeve e transaksioneve tjera të tatimpaguesit” dhe nga letër konfirmimi i pranuar nga Administrata Tatimore, konfirmohet se Kompania është kreditore ndaj Administratës Tatimore për shumën 24,386€, për këtë llogari tatimore. Diferenca ndërmjet shumës së prezantuar në bilancin e gjendjes dhe detyrimit të konfirmuar, në shumën prej 372,005.47€, është shumë për të cilën janë mbivlerësuar detyrimet afatshkurtra. Kjo ka ndodhur si rrjedhojë e mos harmonizimit për vite me radhë të TVSH-së në regjistrat kontabël me gjendjen e deklarimeve dhe borxheve ndaj Administratës Tatimore.

- Sipas SNK 20 - Grantet Qeveritare, Grantet që lidhen me aktivet, përfshirë grantet jo monetare me vlerë të drejtë, duhet të paraqiten në pasqyrën e pozicionit financiar ose duke e njohur grantin si të ardhur të shtyrë ose duke zbritur grantin që merret nga vlera e mbartur e aktivitet.

Llogaria “Detyrimet ndaj granteve” ishte prezantuar në shumën 5,076,691€, shumë kjo e mbivlerësuar për 1,727,052€. Ky mbivlerësim kishte rrjedhë si pasojë e zbatimit të dy

metodave të ndryshme të zhvlerësimit për të njëjtat grante. Në regjistrin e pasurisë është zbatuar metoda lineare e zhvlerësimit me normën 20%, ndërsa në regjistrat kontabël të granteve është zbatuar metoda e saldoshme me shkallë të zhvlerësimit 5%.

Për më tepër, "Të hyrat nga grantet" janë nënvlerësuar për 52,910€, për arsye se zhvlerësimi i pasurive nga grantet sipas regjistrit të pasurive ishte 320,104€, ndërsa njohja kontabël si e ardhur e shtyrë ishte 267,194€.

- Llogaritë e pagueshme tregtare janë detyrime që krijohen gjatë kryerjes së aktiviteteve kryesore të njësisë ekonomike. Ato krijohen si pasojë e blerjes së mallrave apo shërbimeve me pagesë të mëvonshme.

Llogaritë e pagueshme tregtare janë të nënvlerësuar për 10,268€. Kjo shumë e nënvlerësuar rrjedhë si pasojë e gabimeve teknike të bartura nga vitet e mëparshme.

Për më tepër, nga 21 raste të testuara, për nëntë prej tyre në vlerë 13,048€, nuk kemi gjetur dëshmi burimore - fatura apo kontrata që e mbështesin detyrimin e Kompanisë ndaj furnitorëve. Mungesa e dokumenteve burimore për të pagueshmet, ndikon në besueshmërinë e informacionit financiar dhe prezantim jo të saktë të obligimeve në pasqyrat financiare.

Përveç kësaj, testet tona për 10 mostra në shumën 15,141€, tregojnë se detyrimet janë më të vjetra se një vit. Disa nga to datojnë që nga viti 2003 e këtej, për të cilat Kompania nuk ka trajtuar ekzistencën dhe vlerësimin e detyrimeve nëpërmjet procesit të inventarizimit ku do të duhej të barazohej rezultati i këtij procesi me librat kontabël, sipas nenit 12 të Ligjit për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim.

- Sipas SNK 1 një njësi ekonomike duhet të përgatisë pasqyrat financiare të saj, me përjashtim të informacionit mbi rrjedhën e parasë, mbi bazën e kontabilitetit rritës. Qëllimi i pasqyrës së rrjedhës së parasë, sipas SNK 7, është për të plotësuar nevojat e përdoruesve të informacionit kontabël në lidhje me rezultatin monetar, me fluksin e lëvizjes së mjeteve monetare gjatë një periudhe kontabël.

Kompania kishte hartuar pasqyrën e rrjedhës së parasë, mirëpo bazuar në çështjet e ngritura më sipër për zërat kontabël, të pagueshmet tregtare, tatimet e pagueshme, zhvlerësimi, humbjet e vitit, zëra këta që kanë ndikim (mbivlerësimi apo nënvlerësimi i tyre) në rrjedhën e parasë nga aktivitetet operative, vijmë në përfundim se rrjedha e parasë nuk prezanton një informacion të saktë.

- Sipas SNK 1 një pako e pasqyrave financiare duhet të përmbajë edhe një pasqyrë të ndryshimeve në ekuitet ku përfshihet edhe fitimi ose humbja e periudhës. Kompania kishte hartuar këtë pasqyrë, mirëpo për shkak të çështjeve të ngritura në lidhje me të hyrat nga grantet dhe shpenzimet e zhvlerësimit që kanë ndikim në rezultatin financiar në pasqyrën e të ardhurave, humbja e periudhës e bartur në këtë pasqyrë nuk është e saktë.

-
- Sipas SNK 1, shënimet shpjeguese janë një element i pandarë i pasqyrave financiare. Sipas përcaktimeve të bëra në këtë standard këto shënime të pasqyrave financiare duhet të:

- Paraqesin informacion në lidhje me bazat e përdorura për përgatitjen e pasqyrave financiare. Sipas SNK 1, një njësi ekonomike duhet të përgatisë pasqyrat financiare, me përjashtim të informacionit mbi rrjedhën e arkës, mbi bazën akruale (bazë e kontabilitetit rritës).

Edhe pse në fillim të shënimeve shpjeguese, Kompania ka bërë deklaratën e pajtueshmërisë për përgatitjen e pasqyrave financiare në pajtim me SNRF, ajo nuk ka paraqitur informacion të qartë në pjesën narrative mbi bazën e përgatitjes së pasqyrave financiare.

- Paraqesin informacion në lidhje me hipotezën e vijimësisë - Kur menaxhmenti është i ndërgjegjshëm, në bërjen e vlerësimit për pasiguritë materiale të lidhura me ngjarjet ose kushtet të cilat mund të hedhin dyshime mbi aftësinë e njësisë ekonomike për të vazhduar sipas hipotezës së vijimësisë, për këto pasiguri duhet të jepen informacione shpjeguese.

Menaxhmenti i Kompanisë nuk kishte bërë një vlerësim lidhur me ndonjë pasiguri materiale lidhur me vijimësinë e kompanisë, dhe rrjedhimisht nuk ka dhënë as deklaratën nëse pasqyrat financiare janë hartuar nën supozimin e vijimësisë.

- Sipas SNK 37, njësi ekonomike duhet të jap informacion shpjegues për pasuritë dhe detyrimet kontingjente (eventualitetet), përveç kur mundësia e një hyrje/daljeje burimesh që përfshin përfitime ekonomike nuk ekziston më.

Kompania për ngjarjet të cilat i plotësojnë kushtet për trajtimin e tyre si detyrime kontingjente nuk ka dhënë informacione shpjeguese për to. Ato ngjarje ekonomike kanë të bëjnë me 12 lëndë gjyqësore në shumën 166,189€.

- Sipas SNK 20, për grantet qeveritare, duhet të jepen informacione shpjeguese për politikën kontabël të përdorura për grantet, natyrën dhe madhësinë e granteve qeveritare të njohura në pasqyrat financiare, dhe kushtet e paplotësuara të lidhura me ndihmën qeveritare.

Detyrimet ndaj granteve (grante qeveritare dhe ndërkombëtare) ishin në shumën 5,076,691€, për të cilat nuk ishte dhënë asnjë informacion në lidhje me politikën e zbatuara kontabël, natyrën dhe madhësinë e granteve, dhe nëse këto grante kanë kushte specifike që të plotësohen.

- Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare, prezantojnë informacionet shtesë në mënyrë që të plotësohen nevojat e përdoruesve me informacion mbi përbërjen e elementeve të bilancit dhe pasqyrës së të ardhurave. Ato zakonisht përmbajnë informacion edhe për politikën kontabël të përdorura nga njësi ekonomike për hartimin e pasqyrave financiare.

Informacioni i dhënë nga Kompania në shënimet shpjeguese është i mangët për politikën kontabël të matjes së stoqeve, vlerën kontabël të stoqeve sipas klasifikimeve më përshtatshme, si dhe vlerën e stoqeve të njohura si shpenzime të periudhës kontabël; politikat kontabël të matjes së klasës së pasurive (prona, impiante dhe pajisjet); dhe provizionimin e llogarive të arkëtueshme.

Për më tepër, ka mospërputhje ndërmjet shënimeve shpjeguese për të arkëtueshmet dhe shifrave në pasqyrën e pozicionit financiar, pasi që nuk janë dhënë sqarime për të ardhurat nga provizionimi i të arkëtueshmeve në shumën 60,364€

Përveç kësaj, për zërat 'shpenzimet e pagave' dhe 'llogaritë e pagueshme' nuk ka informacione shtesë në lidhje me to.

- Sipas SNK 1, një grup i plotë i pasqyrave financiare të publikueshme për qëllime të përgjithshme përfshinë: Pasqyrën e pozicionit financiar në fund të periudhës, pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të të ardhurave gjithëpërfshirëse për periudhën, pasqyrën e ndryshimeve në kapitalin neto për periudhën, pasqyrën e flukseve të mjeteve monetare për periudhën, dhe shënimet, që përfshijnë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme dhe shënimeve të tjera shpjeguese.

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Përgjegjësitë tona në bazë të këtyre standardeve përshkruhen më tej në paragrafin e raportit "Përgjegjësitë e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e Pasqyrave Financiare". Në përputhje me ONISA-P-10 dhe SNISA 130, si dhe me kërkesat e tjera të rëndësishme për auditimin e PFV-ve të Ndërmarrjeve Publike dhe Kodin e Etikës së ZKA-së, ZKA-ja është e pavarur nga KRU Bifurkacioni sh.a. Besojmë se provat e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për të siguruar bazën për opinion.

Përgjegjësitë e menaxhmentit për Pasqyrat Vjetore Financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF). Po ashtu, menaxhmenti është përgjegjës për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare pa keqdeklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë gjithashtu zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime), Ligjin nr. 04/L-087 për Ndërmarrjet Publike (me plotësime dhe ndryshime), dhe Ligjit 06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim.

Menaxhmenti është po ashtu përgjegjës për kryerjen e transaksioneve financiare në pajtim me kornizën e aplikueshme ligjore.

Bordi i Drejtorëve është përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të KRU Bifurkacioni sh.a.**Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve**

Objektivat tona janë të marrim siguri të arsyeshme se Pasqyrat Financiare janë në tërësi të lira nga keqdeklarimi material, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe kështu të nxjerrim një raport të auditorit që përfshinë opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është niveli i lartë sigurie, por nuk garanton se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdoherë keqdeklarimet materiale që ekzistojnë. Keqdeklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, me arsye pritet që të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra në bazë të këtyre Pasqyrave Financiare.

Si pjesë e auditimit, në përputhje me SNISA-t, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe mbajmë skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keqdeklarimit material të Pasqyrave Financiare, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit; hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit konform atyre rreziqeve, si dhe sigurojmë dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të duhura për të siguruar bazën për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një keqdeklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për keqdeklarimin që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulimin, falsifikimin, lëshime të qëllimshme, keqpërfaqësime apo anashkalimin e kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme në rrethanat, por jo me qëllim të shprehjes së opinionit për efikasitet të kontrollit të brendshëm të KRU Bifurkacioni sh.a.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të përdorura kontabël dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet përkatëse të bëra nga menaxhmenti.
- Nxjerrim një përfundim nëse baza e vijimësisë së kontabilitetit është e përshtatshme për përdorim nga menaxhmenti, bazuar në provat e siguruar të auditimit, nëse ekziston pasiguria materiale në lidhje me ngjarje apo kushte që mund të hedhin dyshime të rëndësishme në aftësinë e KRU Bifurkacioni sh.a., për të vazhduar sipas parimit të vijimësisë. Nëse konkludojmë se ekziston një pasiguri materiale, nga ne kërkohet që të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit për shpalosjet përkatëse në Pasqyrat Financiare ose, nëse zbulimet e tilla janë të papërshtatshme ta modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona bazohen në provat e auditimit të marra deri në datën e raportit tonë të auditimit. Sidoqoftë, ngjarjet apo kushtet e ardhshme mund të bëjnë që NP-ja të pushojë së vazhduari sipas parimit të vijimësisë.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e Pasqyrave Financiare, përfshirë edhe shpalosjet, për t'u siguruar se Pasqyrat Financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ne komunikojmë me menaxhmentin e entitetit të audituar në lidhje me fushëveprimin, kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Ne, gjithashtu i ofrojmë menaxhmentit deklaratën që ne i kemi zbatuar kërkesat përkatëse etike lidhur me pavarësinë, dhe iu komunikojmë atyre të gjitha marrëdhëniet dhe çështjet e tjera që në mënyrë të arsyeshme mund të mendohet se vënë në dyshim pavarësinë tonë, si dhe masat mbrojtëse, aty ku është e zbatueshme. Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Ne i përshkruajmë këto çështje në raportin e auditimit.

Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si sensitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjisllacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe Rekomandimet

Ne kemi kryer auditimin e Pasqyrave Financiare Vjetore të KRU Bifurkacioni sh.a., për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit si dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit. Ekzaminimet e auditimit janë kryer për të na mundësuar dhënien e opinionit për Pasqyrat Financiare Vjetore.

Lëndë të auditimit kanë qenë edhe efektiviteti i sistemit të kontrollit të brendshëm, si dhe pajtueshmëria me kornizën ligjore dhe rregullative, por jo për qëllime të dhënies së opinionit.

Gjetjet dhe rekomandimet e përfshira në këtë pjesë kanë për qëllim përmirësimin e raportimit financiar dhe evitimin e dobësive në sistemin e kontrollit të brendshëm. Megjithatë, çështjet e ngritura në këtë raport nuk mund të konsiderohen si një pasqyrim i plotë i të gjitha dobësive që ekzistojnë ose të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen.

Ne po ashtu, kemi rishikuar statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe kemi vlerësuar nivelin e zbatimit të tyre. [Për detajet shih shtojcën II.]

Zyra Kombëtare e Auditimit vlerëson bashkëpunimin e menaxhmentit dhe personelit të Ndërmarrjes publike KRU Bifurkacioni sh.a., gjatë zhvillimit të procesit të auditimit.

2.1 Rekomandimet për opinionin

Rekomandimi A1 Bordi i Drejtorëve të sigurojë një rishikim gjithëpërfshirës të regjistrit të pasurisë dhe veprime konkrete përmirësuese në përputhje me kërkesat e SNK 16, për rivlerësimin dhe rishikimin e jetës së dobishme të pasurive.

Rekomandimi A2 Bordi i Drejtorëve të sigurojë se janë marrë veprimet e duhura për korrigjimin shpenzimeve të zhvlerësimit të pasurive në tërësi, si dhe një rishikim gjithëpërfshirës të regjistrit të pasurive në lidhje me vlerësimin për zgjatjen e jetës së dobishme, apo heqjen nga regjistri për pasuritë me vlerë neto zero në libra.

Rekomandimi A3 Bordi i Drejtorëve të sigurojë që të dhënat kontabël janë harmonizuar me gjendjen e borxheve ndaj Administratës Tatimore për llogaritë tatimore të TVSH-së si dhe për të gjitha llogaritë tjera tatimore.

Rekomandimi A4 Bordi i Drejtorëve të sigurojë prezantimin e saktë të detyrimit ndaj granteve dhe të hyrat nga grantet në pasqyrat financiare si dhe zbatimin e harmonizimeve periodike në mes të regjistrave kontabël për grantet me të ardhurat e shtyra.

Rekomandimi A5 Bordi i Drejtorëve të sigurojë që janë marrë veprimet e nevojshme për t'i korigjuar gabimet në lidhje me detyrimet në të dhënat kontabël, në mënyrë që të bëhet një prezantim i saktë në pasqyrat financiare. Përveç kësaj, të krijohen mekanizma që regjistri i obligimeve të rishikohet në baza të rregullta kohore në mënyrë që të vërtetohet plotësia dhe saktësia e listës së detyrimeve ndaj furnitorëve.

Rekomandimi A6 Bordi i Drejtorëve të sigurojë se janë bërë korigjimet e gabimeve të identifikuara tek pasqyra e rrjedhës së parasë dhe pasqyra e ndryshimeve në ekuitet, për një pamje të drejtë dhe të vërtetë të tyre.

Rekomandimi A7 Bordi i Drejtorëve të sigurojë që shënimet shpjeguese, përmbajnë parimet bazë që përdoren për hartimin e pasqyrave financiare dhe informacionet mbi përbërjen e zërave të pasqyrave, janë dhënë sipas kërkesave të standardeve të kontabilitetit.

Rekomandimi A8 Bordi i Drejtorëve të sigurojë se është bërë një analizë e shkaqeve të cilat kanë ndikuar në modifikimin e opinionit dhe të ndërmerren veprime për t'i adresuar këto shkaqe në mënyrë sistematike. Kjo qasje do të parandalonte gabimet në pasqyrat financiare vjetore duke siguruar kështu një pamje të drejtë dhe të vërtetë të tyre.

Përgjigjja e menaxhmentit: Pajtohen me të gjitha çështjet tek baza për opinion.

2.2 Gjetjet për çështjet e kontabilitetit dhe të pajtueshmërisë

Politikat dhe procedurat kontabël

Çështja A9: Mos hartimi i Udhëzuesit për Politikat dhe procedurat kontabël

Kriteri Sipas SNK 8 “Politikat Kontabël, Ndryshimet në Vlerësimet Kontabël dhe Gabimet”, një njësi ekonomike zgjedh dhe zbaton politikat e tij kontabël me qëndrueshmëri për transaksione, ngjarje dhe kushte të tjera të ngjashme. Sipas këtij standardi politikat kontabël janë parimet, bazat, marrëveshjet, rregullat dhe praktikatat e veçanta që zbatohen nga një njësi ekonomike në përgatitjen dhe paraqitjen e pasqyrave financiare. Ato përfshijnë gjykime të bazuara në informacionet më të fundit të besueshme, të disponueshme.

Gjetja Përkundër faktit se Kompania ka një numër të rregulloreve, sipas Ligjit për NP ende nuk ka politika të qarta të gjykimeve dhe vlerësimeve kontabël të përdorura për hartimin e pasqyrave financiare vjetore. Kjo çështje ishte ngritur dhe rekomanduar edhe në raportin e auditorit të jashtëm të vitit të kaluar.

Si pasojë e vëmendjes së pamjaftueshme të Bordit të Drejtorëve për çështje të cilat mund të rrezikojnë objektivat strategjike të Kompanisë, kjo çështje ende nuk ishte adresuar.

Ndikimi Në mungesë të këtyre politikave dhe procedurave kontabël, mund të cenohet pjesa thelbësore e përgatitjes së pasqyrave financiare dhe keq deklarimit të zërave material.

Rekomandimi A9 Bordi i Drejtorëve të sigurojë hartimin e udhëzuesit të politikave dhe procedurave kontabël dhe zbatimin e tij në mbajtjen e librave kontabël dhe raportim financiar.

Përgjigjja e menaxhmentit: Pajtohen.

Stoqet

Vlera e zërit financiar të stoqeve e prezantuar në pasqyrën e pozicionit financiar ishte 190,441€. Ato kanë të bëjnë kryesisht me materiale, pjesë rezervë, vaj dhe naftë të cilat janë të lidhura me funksionimin e shërbimeve që ofron Kompania për ujësjellës dhe kanalizim. Kemi testuar 16 mostra për teste substanciale në vlerë 40,616€ si dhe është trajtuar raporti i regjistrimit të stoqeve për teste të pajtueshmërisë.

Çështja A10: Mos inventarizimi i stokut të naftës dhe mos harmonizimi i raportit të komisionit të inventarizimit me regjistrat kontabël të stoqeve

Kriteri Sipas Ligjit Nr.06/L- 032 për kontabilitet, raportim financiar dhe auditim, shoqëritë tregtare të paktën një herë në vit duhet të verifikojnë ekzistencën dhe vlerësimin e pasurive, detyrimeve dhe kapitalit, nëpërmjet inventarizimit të këtyre zërave dhe dëshmive të tyre mbështetëse. Rezultatet nga raporti i inventarizimit duhet të barazohen me librat kontabël.

Gjetja Sipas librave kontabël dhe pasqyrave financiare, vlera e stokut për naftë ishte prezantuar 4,232€, shumë për të cilën nuk kemi mundur të marrim siguri që paraqet gjendje të saktë të stoqeve. Kjo për arsye se Komisioni për numërimin e stoqeve në fund të vitit nuk kishte bërë regjistrimin e sasisë së naftës në depon qendrore në Ferizaj dhe në depon në Pleshinë. Përveç kësaj, Komisioni i inventarizimit në raportin e tij, ka evidentuar stoqe të cilat janë jashtë përdorimit për shkak të defekteve si dhe stoqe të vjetra të cilat nuk janë evidentuar ndaras nga stoqet tjera dhe këto dëmtime nuk janë korrigjuar në librat kontabël.

Sipas zyrtarit kryesor të depon, kjo situatë ka ndodhur si shkak i mungesës së aparaturës për matje të sasisë së naftës, ndërsa mos korrigjimi i stokut të dëmtuar në librat kontabël ishte rrjedhojë e mungesës së njohurive të zyrtarit përkatës.

Ndikimi Mos inventarizimi i gjendjes së stokut të naftës, si dhe mos korrigjimi në librat kontabël për dëmtimet e stoqeve, reflekton me pasqyrim jo real të gjendjes së pasurisë në pasqyrën e pozicionit financiar të kompanisë.

Rekomandimi A10 ¹ Bordi i Drejtorëve të sigurojë se bëhet matja e sasisë së naftës, gjatë procesit të inventarizimit të stoqeve si dhe të bëhen korrigjimet e nevojshme kontabël për stoqet e dëmtuara, për të siguruar saktësinë e vlerës së stoqeve të prezantuar në pasqyrat financiare.

¹ Çështja A dhe rekomandimi A-nënkuptojnë çështjet dhe rekomandimet e reja;
Çështja B dhe rekomandimi B-nënkuptojnë çështjet dhe rekomandimet e përsëritura;
Çështja C dhe rekomandimi C-nënkuptojnë çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.

Përgjigja e menaxhmentit: Pajtohen.

Pasuritë jo qarkulluese

Vlera neto e zërit financiar të pasurive jo qarkulluese e prezantuar në pasqyrën e pozicionit financiar ishte 7,998,059€. Ato kanë të bëjnë kryesisht me toka, ndërtesat, infrastruktura e rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit, pajisjet dhe makineritë, inventari dhe pajisjet dhe softuerët kompjuterik. Kemi testuar 100 mostra për teste substanciale të detajeve në vlerë 3,115,020€ si dhe 7 mostra për teste të pajtueshmërisë. Përveç kësaj kemi kryer Procedurat analitike substanciale për popullacionin në tërësi sa i përket zhvlerësimit.

Çështja A11: Mos harmonizimi në mes të regjistrit të pasurisë dhe raportit të Komisionit për inventarizim

Kriteri Neni 12 i Ligjit për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim (nr. 06/L-032) në mes tjerash kërkon që shoqëritë tregtare të verifikojnë të paktën një herë në vit, ekzistencën dhe vlerësimin e pasurive nëpërmjet procesit të inventarizimit dhe ky inventarizim duhet të barazohet me librat kontabël.

Gjetja Kompania nuk kishte bërë harmonizimin në mes të regjistrit të aseteve dhe raportit të komisionit për inventarizim.

Sipas zyrtarëve të Kompanisë kjo ka ndodhur për shkak të mos vendosjes së numrit identifikues për secilin aset, nëpërmjet të cilit do të bëheshin korrigjimet e nevojshme të evidentuara nga komisioni i inventarizimit.

Ndikimi Mos harmonizimi i gjendjes faktike të pasurisë me regjistrat kontabël rezultojnë me prezantime dhe shpalosje jo të sakta të pasurisë në pasqyrat financiare.

Rekomandimi A11 Bordi i Drejtorëve të sigurojë se janë marrë veprimet korrigjuese në lidhje me ndryshimet e nevojshme në regjistrin e pasurisë, sipas gjendjes faktike të konstatuar dhe përmes zbatimit të harmonizimeve periodike në mes të raporteve të komisioneve për inventarizim dhe vlerësim me regjistrin e pasurisë.

Përgjigja e menaxhmentit: Pajtohen.

Të Hyrat

Të hyrat e realizuara ishin në vlerë 2,402,109€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga furnizimi me ujë të pijshëm dhe mbledhje të ujërave të zeza në komunat Ferizaj, Kaçanik dhe Hani i Elezit. Kemi testuar 104 mostra për teste substanciale të detajeve në vlerë 8,072€ si dhe 3 mostra për teste të pajtueshmërisë. Përveç kësaj, kemi kryer procedurat analitike substanciale për të hyrat nga inkasimi i të arkëtueshmeve të provizionuara dhe nga blerësit e shërbimeve tjera në vlerë prej 327,559€.

Çështja A12: Mos vendosja e ujëmatësve në të gjitha daljet e ujit të prodhuar

Kriteri Sipas Rregullores së ARRU² Nr.08/2018, Neni 3.3.1 për ndryshim dhe plotësim të Rregullores Nr.02/2016 për Standardet Minimale të Ujit në Kosovë, kërkohet që të vendosen/instalohen pajisjet për matjen e ujit në të gjitha daljet e fabrikës/puseve për përpunimin e ujit të pijshëm.

Gjetja Kompania kishte gjithsej 15 qendra të përpunimit të ujit (rezervuarëve), nga të cilat vetëm në një prej tyre (në qendrën kryesore) është vendosur ujëmatës për matjen e ujit të prodhuar, që përbën 66% të zonës së shërbimit ndërsa pjesa tjetër në shkallën 34% e zonës së shërbimit, uji i prodhuar është i vlerësuar (pa ujëmatës të vendosur për matjen e saktë të ujit të prodhuar).

Njëra prej arsyeve të mos vendosjes së këtyre ujëmatësve deri tani ishte kostoja e papërbalueshme, mirëpo Kompania është në procedura me mbështetje prej donatoreve për realizim të këtij projekti.

Ndikimi Mos vendosja e ujëmatësve në të gjitha qendrat e përpunimit dhe prodhimit të ujit, përveç që është në kundërshtim me kërkesat e rregullores së autoritetit rregullator të ujit, ndikon edhe në prezantim jo të saktë të humbjeve të ujit.

Rekomandimi A12 Bordi i Drejtorëve të sigurojë se janë vendosur ujëmatës në të gjitha qendrat e përpunimit dhe prodhimit të ujit, dhe përmes kësaj të konstatohet humbja e saktë e ujit, në mënyrë që pastaj të mundësohet marrja e masave për shkaqet tjera të humbjeve të ujit.

Përgjigjja e menaxhmentit: Pajtohen.

² Autoriteti Rregullator për shërbimet e Ujit

Shpenzimet e Pagave

Shpenzimet e pagave ishin 1,229,588 €. Numri i të punësuarve në fund të vitit ishte 201. Gjatë vitit ishin punësuar tre punonjës të rinj. Kemi testuar 100 mostra për teste substanciale në vlerë 53,232€ si dhe 10 mostra për teste të pajtueshmërisë.

Çështja A13: Pozita aktuale të punës jo të parapara me organogram dhe rregullore

Kriteri Me Rregulloren për paga, reprezentacion, mëditje, dënime, stimulime dhe shpenzime tjera, nr. 1468, të vitit 2010, janë paraparë pozitat e punës, kushtet, kriteret dhe lartësia e pagës. Pozitat e punës janë azhurnuar duke shtuar disa pozita të reja me organogramin e aprovuar në vitin 2017.

Gjetja Testet tona, tregojnë se 18 pozita aktuale të punës nuk janë të parapara me rregulloren për paga dhe mëditje, ku tetë prej tyre janë paraparë me organogram kurse nëntë pozita aktuale nuk janë paraparë as me rregullore e as në organogram. Për më tepër, zyra e formuar në Han të Elezit dhe katër pozitat e punës për këtë zyre, nuk janë paraparë në rregullore dhe në organogram.

Kjo ka ndodhur për shkak të vëmendjes së pamjaftueshme të Bordit të Drejtorëve dhe menaxhmentit, në azhurnimin dhe plotësimin e rregulloreve dhe organogramit konform nevojave aktuale të ndërmarrjes.

Ndikimi Punësimi i punonjësve, për pozita të punës që nuk ishin të parapara në rregullore dhe organogram, rrit rrezikun që punonjësit e pranuar të jenë kompetent, në mungesë të kriterëve dhe kushteve të përcaktuara për këto pozita dhe kjo pastaj mund të ndikoj në mos arritjen e objektivave të ndërmarrjes.

Rekomandimi A13 Bordi i Drejtorëve të sigurojë që rregulloret dhe organogrami, rishikohen në baza të rregullta kohore dhe azhurnohen e plotësohen konform nevojave reale dhe aktuale të Kompanisë.

Përgjigjja e menaxhmentit: Pajtohen.

Çështja A14: Pagesa e përvojës së punës jo në përputhje me rregulloren e brendshme për paga

- Kriteri** Sipas “Rregullores për paga, reprezentacion, mëditje, dënime, stimulime dhe shpenzime tjera” nr.1468, theksohet se punëtorëve ju njihet e drejta për përvojë në punë 0.3% të pagës bazë për çdo vit të plotë të përvojës në punë, kur kompania krijon kushte financiare dhe stabilitet financiar për përmbushjen e një obligimi të tillë.
- Gjetja** Testet tona, tregojnë se Kompania kishte paguar 24,986€ me shumë se sa do të duhej të paguhet përvoja e punës sipas rregullores. Kjo kishte ndodhur pasi që departamenti i burimeve njerëzore kishte aplikuar gabimisht normën 0.5% duke u thirrur në vendimin e Qeverisë Nr.06/29, të vitit 2015, i cili është obligativ vetëm për organizatat buxhetore.
- Ndikimi** Mos harmonizimi i pagesës së përvojës së punës, me rregulloren e brendshme për paga, ndikon në rritjen e shpenzimeve më të mëdha se që janë parashikuar, krijon parakushte për anashkalimin e rregullores me rastin e trajtimit të rasteve tjera dhe rrit mundësinë e shpenzimeve për paga që nuk janë të parapara me rregullore.
- Rekomandimi A14** Bordi i Drejtorëve të sigurojë se rregulloret, rishikohen në baza të rregullta dhe azhurnohen e plotësohen sipas nevojës, pagesat e përvojës së punës të bëhen në harmoni me rregulloren e brendshme për paga dhe legjislacionin e aplikueshëm në fuqi për pagat.

Përgjigjja e menaxhmentit: Pajtohen.

Çështja A15: Mangësi në njoftimin e kandidatëve për test dhe intervista

Kriteri Sipas “Udhëzimit Administrativ për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik”, nr. 07/2017, neni 8, kërkohet që mënyra e njoftimit të kandidatëve për test të jetë me shkrim.

Gjetja Testimet tona, tregojnë se në tre procese të rekrutimit “Zyrtar Kryesorë i Financave dhe Thesarit”, “Zyrtar i Auditimit të Brendshëm” dhe për pozitën “Mikrobiolog”, nuk kishte dëshmi për mënyrën se si janë ftuar kandidatët në test me shkrim dhe në intervistë.

Kjo ka ndodhur si shkak i mos aplikimit të drejtë të kërkesave të udhëzuesit administrativ për rregullimin e procedurave të konkursit.

Ndikimi Mungesa e dëshmive se si janë ftuar kandidatët në test me shkrim dhe intervistë është rrezik potencial që të mos informohet ndonjë nga kandidatët për pjesëmarrje në të gjithë procesin e rekrutimit.

Rekomandimi A15 Bordi i Drejtorëve të sigurojë mënyra e njoftimeve, lidhur me aplikuesit për punësim, të jenë në harmoni me udhëzimin administrativ që rregullon procedurat e konkursit në sektorin publik.

Përgjigjja e menaxhmentit: Pajtohen.

Çështja A16: Komisioni në përbërje jo të plotë në rastin e vlerësimit të procesit të rekrutimit

- Kriteri** Sipas “Udhëzimit Administrativ për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik”, nr. 07/2017, neni 7, kërkohet që komisioni i përzgjedhjes përbëhet prej tre anëtarëve, Kryesuesit të komisionit dhe dy anëtarë.
- Gjetja** Testimet tona, tregojnë se për konkursin “Zyrtar Kryesor i Financave dhe Thesarit” edhe përkundër vendimit që Komisioni ishte caktuar në përbërje prej kryesuesit dhe dy anëtarëve, vlerësimi i testit me shkrim dhe ai i intervistave ishte kryer vetëm nga dy anëtarët e Komisionit. Ndërsa procesverbali i procesit të rekrutimit ishte nënshkruar nga të tre anëtarët e caktuar sipas vendimit.
- Kjo ka ndodhur si shkak i mos vëmendjes së mjaftueshme të Kryesuesit të Bordit për të siguruar respektim të plotë të procedurave formale në funksionalizimin e plotë të Komisionit.
- Ndikimi** Mungesa e njërit nga anëtarët për vlerësimin e kandidatëve, nuk siguron transparencën e duhur në përzgjedhjen e kandidatit për pozitën përkatëse dhe mund të rezultojë në vlerësim jo të drejtë.
- Rekomandimi A16** Bordi i Drejtorëve të sigurojë që vlerësimi i kandidatëve bëhet nga komisioni i përbërë prej tre anëtarëve, duke siguruar kështu proces transparent dhe të drejtë për të gjithë kandidatët.

Përgjigjja e menaxhmentit: Pajtohen.

Çështja A17: Ndarje e mjeteve financiare në emër të stimulimit të punonjësve përkundër operimit me humbje të Kompanisë

Kriteri Sipas “Rregullores për paga, reprezentacion, mëditje, dënime, stimulime dhe shpenzime tjera”, varësisht nga gjendja dhe fuqia financiare e Kompanisë, të punësuarve mund t’u ndahen mjete financiare me rastin e festave fetare, kombëtare, festave të fund vitit.

Gjetja Kryeshefi Ekzekutiv, edhe përkundër operimit me humbje të Kompanisë, me rastin e festës së Vitit të ri, të gjithë punonjësve ju kishte ndarë nga 30€ neto pa obligim kthimi. Shuma totale ishte 6,994€.

Sipas zyrtarëve, arsyeja e marrjes së vendimit për ndarje të mjeteve financiare për punonjësit, ka të bëjë me përpjekjen për krijimin e një atmosfere stimuluese pozitive për performancë më të mirë për vitin vijues.

Ndikimi Ndarja e mjeteve financiare për punonjësit, në situatën kur Kompania operon me humbje, ndikon në thellimin e më tejshëm të humbjeve të Kompanisë dhe është shembull jo adekuat për të stimuluar përmirësimin e performancës.

Rekomandimi A17 Bordi i Drejtorëve të sigurojë se ndarja e mjeteve financiare, në emër të stimulimit të punonjësve, të bëhet vetëm kur Kompania ka fuqinë e duhur financiare.

Përgjigjja e menaxhmentit: Pajtohen.

Çështja A18: Shtesat dhe beneficioni i Anëtarëve të Bordi jo në pajtim me ligjin për ndërmarrjet publike

Kriteri Sipas Ligjit Për Ndërmarrjet Publike, NP është përgjegjëse për pagimin e të gjithë kompensimit për drejtorët e saj vetëm nga pagesat e parapara me Vendimin e Aksionarit. Drejtorët e NP nuk do të marrin asnjë kompensim ose përfitim tjetër nga NP.

Gjetja Testimet tona tregojnë se dy nga anëtarët e Bordit të Drejtorëve ishin kompensuar edhe me shtesën e përvojës së punës, për gjithë vitin në shumën 326€, përkatësisht për muajin dhjetor, në shumën 36€. Pas trajtimit të kësaj çështje nga ana e jonë, sipas zyrtarit nga Burimet Njerëzore, ky ishte një gabim teknik nga ana e Departamentit të Administratës, por i cili do të përmirësohet në mënyrë retroaktive më pagesat për muajit e ardhshëm.

Përveç kësaj, për Drejtorët jo ekzekutiv të Bordit, ishin realizuar pagesat për mbushje telefonike për çdo muaj të vitit fiskal. Shuma totale e këtyre shpenzimeve ishte 692€.

Sipas zyrtarëve të Kompanisë, pagesa për këto shpenzime ka ndodhur si rrjedhojë e vazhdimësisë së praktikave të zbatuara nga vitet e mëparshme, bazuar në një procesverbal të takimit të Bordit të Drejtorëve të mbajtur me 16.04.2014

Ndikimi Pagesa e shtesave dhe beneficioneve tjera, përveç kompensimit për anëtarët e bordit, cilësohet se është jo në përputhje me Ligjin për ndërmarrjet publike dhe cilësohet e parregullt.

Rekomandimi A18 Bordi i Drejtorëve të shfuqizojë vendimin i cili është në kundërshtim me ligjin për sigurojë që niveli i pagesave të Bordit të jetë sipas Vendimit të Qeverisë për punën e kryer në Borde dhe Komisione në përputhje me kornizën ligjore.

Përgjigjja e menaxhmentit: Pajtohen.

Shpenzimet operative dhe shpenzimet tjera

Shpenzimet operative dhe shpenzimet tjera janë realizuar në shumën 300,933€. Ato kanë të bëjnë me shpenzimet e riparimit dhe mirëmbajtjes, shpenzimet administrative, shpenzimet e energjisë dhe derivateve, shpenzimet e marketingut dhe shpenzime tjera operative. Kemi testuar 47 mostra për teste substanciale në shumën 44,873€ si dhe 13 mostra për teste të pajtueshmërisë (përfshirë 10 procedura të prokurimit dhe tre mostra për blerjet direkte).

Çështja A19: Statusi i pa definuar me marrëveshje lidhur me shfrytëzimin e automjetit në pronësi të Kuvendit Komunal të Ferizajit

Kriteri Standardet Ndërkombëtare IPSAS³ dhe Korniza Konceptuale paragrafi 5, BC5.10, thekson se pronësia ligjore e një pasurie si një qasje në shërbime potenciale ose në përfitime ekonomike të një pasurie është një tregues i kontrollit. Mirëpo, të drejtat për shërbime potenciale ose aftësia për të gjeneruar përfitime ekonomike, mund të ekzistojnë pa pronësinë ligjore të pasurisë nëpërmjet mbajtjes dhe përdorimit të pasurisë.

Gjetja Kompania kishte realizuar shpenzime për regjistrimin e automjetit “Kamion cisternë”, në shumën 963€, me statut pronësor në emër të Kuvendit Komunal Ferizaj. Ky automjet shfrytëzohej për nevojat operacionale të Kompanisë, mirëpo pa ndonjë marrëveshje të shkruar ndërmjet tyre.

Kjo kishte ndodhur për shkak se menaxhmenti i Komunës dhe KRU Bifurkacionit, nuk e kishin konsideruar të nevojshme hartimin e një marrëveshje të shkruar lidhur me të drejtat/obligimet për bartjen e pasurisë së Komunës në shfrytëzim tek Kompania.

Ndikimi Statusi i pa definuar me marrëveshje për shfrytëzim, krijon parakushte për keqpërdorime të mundshme, dhe mos njohje të shpenzimeve të zbritshme nga autoriteti tatimor.

Rekomandimi A19 Bordi i Drejtorëve të sigurojë se janë ndërmarrë veprime konkrete, për definimin me marrëveshje të statusit të pasurisë së Komunës, të bartur në shfrytëzim tek Kompania, ku përcaktohet kohëzgjatja, të drejtat, obligimet dhe përgjegjësitë e palëve.

Përgjigjja e menaxhmentit: Pajtohen.

³ Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik

Çështja A20: Mos emërimi i zyrtarit për certifikimin e pagesave

Kriteri Sipas Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë kërkohet që “Çdo Organizatë Buxhetore, agjenci autonome ekzekutive dhe ndërmarrje publike të ketë Zyrtarin Certifikues. Zyrtari Certifikues është përgjegjës të sigurojë që kushtet e zbatueshme të një kontrate publike të jenë përmbushur para bërjes ose autorizimit të pagesave sipas kontratës.

Gjetja Kompania nuk kishte emëruar ende një zyrtar për certifikimin e pagesave. Këtë rol e mbulon pjesërisht, Zyrtari Kryesor Financiar, mirëpo kjo nuk është një ndarje e duhur e detyrave pasi që i njëjti menaxhon edhe me llogaritë bankare dhe bën certifikimin e pagesave. Për më tepër, pozita e zyrtarit certifikues nuk ishte paraparë as në strukturën organizative të Kompanisë.

Sipas pohimeve të sekretarit të Kompanisë, emërimi i Zyrtarit Certifikues nuk ishte paraparë deri në këtë fazë, për shkak të ndryshimeve në organogram të cilat parashihen të ndodhin në të ardhmen sipas modelit unik të organogrameve për shtatë Kompanitë Rajonale të Ujësllësit.

Ndikimi Mos emërimi i Zyrtarit Certifikues, reflekton me zvogëlim të kontrollit efektiv dhe monitorimit nga ana e menaxhmentit, për përmbushje të kërkesave kontraktuale para autorizimit të pagesave.

Rekomandimi A20 Bordi i Drejtorëve të sigurojë një rishikim të strukturës organizative të stafit për plotësim të pozitës, si dhe të sigurojë emërimin e zyrtarit certifikues, duke mundësuar forcim të kontrolleve të brendshme, parandalim të konflikteve të interesit dhe respektim të rregullave të Kontrollit dhe Menaxhimit Financiar para procedimit të pagesave.

Përgjigjja e menaxhmentit: Pajtohen.

Çështja A21: Mos hartimi i rregullores për menaxhimin e shpenzimeve

Kriteri Neni 7, i Statutit të ndërmarrjes specifikon se Ndërmarrja duhet të nxjerrë rregulloret, të cilat përmbajnë dispozita për administrimin dhe funksionimin e saj.

Gjetja Menaxhmenti i Kompanisë nuk kishte hartuar rregullore ku do të përcaktohej rrjedha e dokumentacionit të shpenzimeve, përgjegjësitë, si dhe procedurat për menaxhimin e shpenzimeve sipas shtrirjes së kompanisë në tri regjione. Përveç kësaj, testet tona për shpenzimet për mallra dhe shërbime tregojnë se faturat e pranuar nga furnitorët nuk ishin protokolluar.

Shkak për këtë ishte mos përkushtimi i duhur nga ana e Menaxhmentit, për hartimin e rregullores që përcakton rrjedhën e dokumentacionit të shpenzimeve, ndërsa sipas pohimeve të sekretarit të Kompanisë rregullorja do të hartohet në të ardhmen duke u bazuar në modelet e KRU-ve tjera qendrore.

Ndikimi Mungesa e rregullores për menaxhimin e shpenzimeve krijon parakushte për parregullsi në rrjedhën e dokumentacionit kontabël dhe rrit mundësitë për gabime apo keqpërdorime financiare.

Rekomandimi A21 Bordi i Drejtorëve të sigurojë hartimin e rregullores për menaxhimin e shpenzimeve ku do të përcaktohen qartë procedurat dhe kontrollet referuar standardeve, kërkesave të legjislacionit relevant në fuqi si dhe nevojave të organizimit të Kompanisë. Po ashtu, të sigurojë se të gjitha faturat e pranuar të shpenzimeve, protokollohen në datën e pranimit të tyre, në mënyrë që të shmangen pagesat e dyfishta dhe të menaxhohen me kohë obligimet e ndërmarrjes.

Përgjigjja e menaxhmentit: Pajtohen.

Çështja A22: Ndarja e tenderëve për furnizime/shërbime të njëjta/ndërlidhura

Kriteri Rregullat dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik RRUOPP, neni 5, thekson se përgatitja e planit vjetor të prokurimit: eliminon nevojën për prokurime emergjente apo përjashtime, mbledhë kërkesat kur është e mundshme për të fituar vlerën për parane, mundëson identifikimin e kontratave kornizë dhe eviton ndarjen e kërkesave të prokurimit që janë kryesisht të njëjta ose të ndërlidhura.

Gjetja Nga analizat tona për raportin e kontratave të nënshkuara, identifikuam se ndërmarrja kishte aplikuar ndarje të tenderëve për blerjen e furnizimeve/shërbimeve të njëjta/ndërlidhura, duke përdorur procedurën për vlerë minimale dhe vlerë të vogël. Marrë për bazë vlerën e kontratave të nënshkuara, ndërmarrja për këto blerje do duhej të zhvillonte procedura të hapura të prokurimit sipas kufirit të vlerës së përcaktuar me legjislacion. Rastet e identifikuara për ndarje të tenderëve janë si vijon:

- Tri kontrata për furnizim me pompa drenazhi dhe pompa zhytëse, në vlerë të përbashkët 2,714€;
- Tri kontrata për furnizim me inventar, në vlerë të përbashkët 2,680€;
- Katër kontrata për riparime të automjeteve, në vlerë të përbashkët 3,120€;
- Dy kontrata për sigurimin e automjeteve, kontrollimin teknik dhe regjistrimin e automjeteve, në vlerë të përbashkët 14,593€;
- Tri kontrata për furnizim me printer dhe pajisje të teknologjisë informative, në vlerë të përbashkët 2,197 €; dhe
- Dy kontrata për furnizim me lëndë djegëse për ngrohjen e objekteve, në vlerë të përbashkët 4,700 €.

Sipas pohimeve të zyrtarit të prokurimit, kjo kishte ndodhur edhe përkundër faktit se njësitë kërkuese janë informuar me kohë për evidentim të saktë të kërkesave ashtu që të mund të shmangen mundësitë për ndarje të tenderëve, ndërsa në disa raste ndarja e tillë ka ndodhur për shkak të paraqitjes së nevojave të paparashikuara në terren për furnizime/shërbime.

Ndikimi Ndarjet dhe shmangiet e procedurave të përshtatshme të prokurimit reflektojnë me mungesë transparence dhe kufizim të konkurrencës, duke rrezikuar edhe aspektin kualitativ të furnizimeve të pranuar për parane e shpenzuar.

Rekomandimi A22 Bordi i Drejtorëve të sigurojë një planifikim të drejtë dhe të saktë, duke evituar çfarëdo ndarje të aktiviteteve të njëjta të prokurimit, ashtu që të sigurohet blerje efikase dhe të mundësohet në këtë formë respektimi i kërkesave ligjore për parane e shpenzuar.

Përgjigjja e menaxhmentit: Pajtohen.

Çështja A23: Mos respektimi i afateve kohore ligjore për vlerësimin e tenderëve

Kriteri Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik, neni 41 paragrafi 41.2. përcakton se procesi i vlerësimit të tenderëve do të fillojë menjëherë pas përfundimit të procesit të hapjes së tenderëve dhe jo më vonë se 5 ditë pas përfundimit të procesit të hapjes së tenderëve.

Gjetja Në katër⁴ procedura të prokurimit nga dhjetë të testuara, kishte vonesa për fillim të procesit të vlerësimit të tenderëve nga dy deri në tetë ditë vonesë.

Sipas pohimeve të zyrtarit të prokurimit, formimi i komisioneve vlerësuese është bërë gjithmonë brenda afateve kohore ligjore, dhe se obligimi i komisionit ishte të filloj vlerësimin me kohë, mirëpo vonesat në këto raste janë të pajustificueshme vetëm për komisionin.

Ndikimi Vonesat në fillimin e vlerësimit të tenderëve, rrezikojnë me vlerësim jo të duhur, për shkak të presionit të afatit më të shkurtër kohor dhe kjo mund të shpie edhe në gabime, që mund të pasojnë me ankesa të operatorëve ekonomik.

Rekomandimi A23 Bordi i Drejtorëve të sigurojë se Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit ushtron mbikëqyrje efektive ndaj komisioneve të vlerësimit, në mënyrë që të evitohen rastet e vonesave në vlerësimin e tenderëve.

Përgjigjja e menaxhmentit: Pajtohen

⁴ "Ndërtimi i Stacionit të Pompimit në fshatin Softaj", 2."Ndërtimi i katit të 1-rë të aneksit të objektit të dytë të administratës së KRU Bifurkacioni ", 3."Furnizimi me pjesë të mëdha fazonike për nevojat e KRU Bifurkacioni SH.A. Ferizaj ", 4."Pastrimi i puseve të ujës jellësit të fshatrave Gurëz-Komogllavë Ri-Tender II

Çështja A24: Shpërblimi me kontratë i Operatorëve Ekonomik të papërgjegjshëm

Kriteri Ligji për Prokurim Publik, neni 59.4, thekson se Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.

Gjetja Kompania kishte shpërblyer me kontratë operatorët ekonomik, të cilët nuk kishin dorëzuar të gjitha kërkesat e parashtruara në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë për aktivitetet e prokurimit si në vijim:

- Operatori ekonomik fitues i kontratës “Ndërtimi i katit të 1-rë të aneksit të objektit të dytë të administratës së KRU Bifurkacioni”, nuk kishte dorëzuar letër referencë apo raport të pranimit teknik që do të dëshmonte realizimin me sukses të një kontrate të natyrës së ngjashme në vlerë prej jo më pak se 50,000€.
- Operatori ekonomik fitues i kontratës “Pastrimi i puseve të ujësjetës të fshatrave Gurëz-Komogllavë Ri-Tender II”, nuk kishte dorëzuar letër referencë apo raport të pranimit teknik për të dëshmuar realizimin me sukses së paku të një kontratë të natyrës së ngjashme në tri vitet e fundit. Përveç kësaj, nuk kishte dorëzuar dëshmi të librezave për pronësinë dhe vlefshmërinë e regjistrimit të pajisjeve teknike në dispozicion për ekzekutimin e projektit.

Vlera e përbashkët për dy kontratat e shpërblyera është 40,640 Euro.

Kjo situatë kishte ndodhur nga pakujdesia e anëtarëve të komisionit të vlerësimit dhe mungesës së mbikëqyrjes së procesit të vlerësimit nga njësia e prokurimit.

Ndikimi Shpërblimi me kontratë i operatorëve ekonomik të papërgjegjshëm, rrezikon përmbushjen e kontratave sipas kërkesave të specifikuara në dosjen e tenderit dhe si rrjedhojë mund të shpie edhe në dëme financiare për kompaninë.

Rekomandimi A24 Bordi i Drejtoreve të sigurojë se Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit ushtron mbikëqyrje ndaj komisioneve të vlerësimit, në mënyrë që të evitohen rastet e shpërblimit me kontratë të operatorëve ekonomik, ofertat e të cilëve nuk janë në pajtueshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit.

Përgjigja e menaxhmentit: Nuk pajtohen për pjesën e parë të gjetjes. Më gjerësisht shih Shtojcën 1, komenti 1.

Pozicioni i Auditorit të Përgjithshëm: Interpretimi i dhënë nga Kompania për gjetjen nuk qëndron, shih Shtojcën 1, komenti 1.

Çështja A25: Mos hartimi i planit për menaxhim të kontratës

- Kriteri** Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik, neni 61.7 dhe 61.8, specifikojnë se pas pranimit të kontratës, menaxheri i projektit do të përgatis një plan për menaxhimin e kontratës, duke përdorur formularin standard të miratuar nga KRPP. Plani për menaxhimin e kontratës, do të përgatitet para fillimit të zbatimit të kontratës dhe me pajtimin e palëve të kontratës. Kjo do të dokumentohet me nënshkrimet e të dy palëve, përkatësisht të Menaxherit të Projektit dhe Operatorit Ekonomik.
- Gjetja** Menaxheri i Projektit, për aktivitetin e prokurimit “Furnizimi me pjesë të mëdha fazonike për nevojat e KRU Bifurkacioni SH.A., Ferizaj” dhe “Sigurimi, kontrolli teknik dhe regjistrimi i automjeteve të kompanisë”, nuk kishte hartuar një plan për menaxhim të kontratës.
- Sipas pohimeve të zyrtarit të prokurimit, menaxheri ishte i informuar nga kjo njësi për përgatitjen e planit të menaxhimit të kontratës , mirëpo një plan i tillë nuk ishte hartuar nga ana e tij.
- Ndikimi** Mungesa e planit të menaxhimit të kontratës, rrezikon monitorimin sistematik të zbatimit të kontratës në pajtim me kushtet e përcaktuara në kontratë dhe mund të shpie në devijime të paparashikuara që mund të rezultojnë me pasoja financiare.
- Rekomandimi A25** Bordi i Drejtorëve të sigurojë që për çdo kontratë të prokurimit të nënshkruar, të hartohet plani i menaxhimit të kontratave në mënyrë që të monitorohen dhe të raportohet progresi i zbatimit të tyre.

Përgjigja e menaxhmentit: Pajtohen.

Çështja A26: Mungesa e dokumentacionit për Identifikimin Financiar Bankar të Operatorëve Ekonomik

- Kriteri** Dokumenti i identifikimi financiar në pjesën V të kontratës, kërkon që Ofruesi i Shërbimeve, të plotësojë të dhënat për llogarinë bankare në të cilën do të bëhen pagesat sipas faturës. I njëjti formular që i bashkëngjitet kërkesës për pagesë, duhet të përdoret për t'i raportuar ndryshimet në llogarinë bankare.
- Gjetja** Nga trajtimi jonë i kontratave “Ndërtimi i katit të 1-rë të aneksit të objektit të dytë të administratës së KRU Bifurkacioni”, “Furnizimi me pjesë të mëdha fazonike për nevojat e KRU Bifurkacioni SH.A Ferizaj” dhe “Furnizim me derivate të naftës”, kemi vërejtur se dokumenti për Identifikimin Financiar Bankar nuk ishte plotësuar nga Operatorët Ekonomik fitues të kontratave, dokument ky i cili do duhej të përmbante shënimet e detajuara rreth xhirollogarisë së tyre bankare, ku do të transferoheshin mjetet nga Kompania me rastin e pranimit të punëve/furnizimeve.
- Sipas zyrtarit të prokurimit një lëshim i tillë kishte ndodhur për shkak se ishte konsideruar e mjaftueshme që të dhënat financiare për pagesë të jenë të prezantuara me rastin e dorëzimit të faturës nga ana e kontraktorit.
- Ndikimi** Mungesa e dokumentit të Identifikimit Financiar Bankar me shënimet bankare të validuara nga Operatorët Ekonomik dhe Bankat e tyre përfaqësuese, krijon parakushte për gabime gjatë transferit të pagesave tek Operatorët Ekonomik.
- Rekomandimi A26** Bordi i Drejtorëve të sigurojë se Njësia e Prokurimit, me rastin e nënshkrimit të kontratave merr masat e nevojshme që dokumenti i Identifikimit Financiar Bankar i plotësuar nga Operatorët Ekonomik me shënimet e llogarive të tyre bankare, i bashkëngjitet kontratës, duke siguruar në këtë formë që transferet e pagesave për shërbimet e pranuar bëhen në llogari bankare të autorizuar.

Përgjigjja e menaxhmentit: Pajtohen.

Çështja A27: Mos përfshirja e të gjitha prokurimeve në planin përfundimtar vjetor të prokurimit dhe mos detajimi i planit

Kriteri Ligji për Prokurimin Publik, neni 8, përcakton se çdo autoritet kontraktues do të përgatisë një planifikim përfundimtar me shkrim që i identifikon me detaje të arsyeshme të gjitha furnizimet, shërbimet dhe punët që autoriteti kontraktues synon t'i prokurorë gjatë vitit fiskal. Përveç kësaj, Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ i Prokurimit Publik, neni 5, thekson se përgatitja e planit vjetor të prokurimit: eliminon nevojën për prokurime emergjente si dhe mbledhë kërkesat, kur është e mundshme, për të fituar vlerën për parane.

Gjetja Kompania kishte hartuar "Planin Përfundimtar Vjetor të Prokurimit" të përgjithësuar, i cili nuk ishte i detajuar për secilin produkt, shërbim apo punë që kishte synim të prokurorë. Plani nuk përmbante detaje rreth njësive matëse, sasisë së përafërt vjetore dhe çmimeve për njësi, të produkteve/shërbimeve/punëve të planifikuara.

Për më tepër, dy aktivitete të prokurimit "Ndërtimi i Stacionit të Pompimit në fshatin Softaj" dhe "Pastrimi i puseve të ujësjetllësit të fshatrave Gurëz - Komogllavë Ri-Tender II", nuk ishin përfshirë në planin vjetor të prokurimit edhe përkundër faktit se njësia kërkuese kishte qenë në dijeni për kërkesat e vazhdueshme dhe të arsyeshme të qytetarëve për furnizim të rregullt me ujë të pijshëm, dhe se nevojat e tyre do të realizoheshin përmes këtyre aktiviteteve. Vlera e përbashkët për dy kontratat e shpërblyera është 11,689 Euro.

Sipas njësisë së prokurimit, kjo kishte ndodhur si rrjedhojë e mos parashikimit të projekteve, dhe mos detajizimit të kërkesave nga njësitet kërkuese.

Ndikimi Një plan i përgjithësuar i prokurimit, si dhe mos përfshirja e projekteve në plan krijon mundësi që gjatë kryerjes së procedurave të prokurimit të përfshihen produkte, shërbime, punë të panevojshme të cilat nuk ndërlidhen me realizimin e objektivave të kompanisë përmes kontratave specifike; kosto shtesë për kryerjen e aktiviteteve të prokurimit; dhe mos arritjen e vlerës së synuar për parane.

Rekomandimi A27 Bordi i Drejtorëve të sigurojë se njësia e prokurimit dhe njësitet kërkuese, koordinohen gjatë hartimit të "Planit Përfundimtar Vjetor të Prokurimit", duke mundësuar përgatitjen e një plani të detajuar për secilin produkt, shërbim, punë si dhe të eliminohet çfarëdo nevoje për prokurime jashtë planit.

Përgjigjja e menaxhmentit: Pajtohen.

Çështja A28: Mangësi gjatë hartimit të dosjeve të tenderit dhe vonesa në kryerjen e punëve

Kriteri	Ligji për Prokurim Publik, neni 69.6, thekson se në procedurat që shpijnë në dhënien e kontratës publike në të cilën përfshihet realizimi i projekteve të punëve ose realizimi i aktiviteteve ndërtimore, autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga operatorët ekonomik të sigurojnë të dhënat me të cilat dëshmohet aftësia e tyre teknike dhe profesionale për kryerjen e projekteve të tilla ose realizimin e aktiviteteve të tilla.
Gjetja	<p>Për aktivitetet e prokurimit “Ndërtimi i Stacionit të Pompimit në fshatin Softaj” dhe “Ndërtimi i katit të 1-rë të aneksit të objektit të dytë të administratës së KRU Bifurkacioni”, identifikua mangësi në Dosjet e Tenderit për kërkesat e përshtatshmërisë teknike/dhe ose profesionale, pasi që nuk ishin paraqitur kërkesa lidhur me kualifikimet shkollore dhe profesionale të personelit udhëheqës të operatorit ekonomik dhe në veçanti, të personave drejtpërdrejt përgjegjës për realizimin e projekteve të punëve, si dhe kërkesat lidhur me raportin për fuqinë mesatare punëtore dhe numrin mesatar të personelit udhëheqës të operatorit ekonomik. Përveç kësaj, trajtimi jonë i kontratave të këtyre dy aktiviteteve të prokurimit tregojnë se punët kishin përfunduar me vonesë për 68 dhe 60 ditë respektivisht.</p> <p>Për më tepër, Kompania nuk kishte shfrytëzuar të drejtën e saj për marrjen e dëmeve të likuiduara për shkak të vonesave të kontraktuesve në realizimin e kontratave, për secilën ditë që kalon të barabarta me 0.25% të vlerës së punëve të përcaktuara deri në maksimumin prej 10% të vlerës totale të kontratës, ndërmjet periudhës së skadimit të kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, ashtu siç specifikohet në nenin 8 dhe 9 të kontratave me dy operatorët ekonomik.</p> <p>Sipas pohimeve të zyrtarit të prokurimit, njësi e prokurimit nuk e kishte konsideruar të arsyeshme të përfshihen kërkesat e tilla në dosje të tenderit, si dhe një gjë e tillë nuk ishte kërkuar as nga njësi kërkuuese. Ndërsa sa i përket mos shfrytëzimit të drejtës për marrjen e dëmeve të likuiduara për shkak të vonesave, njësi e prokurimit, nuk ishte informuar në lidhje me to nga menaxherët e projekteve.</p>
Ndikimi	Mangësitë gjatë hartimit të kërkesave për përshtatshmërinë profesionale, shpijnë drejt shpërblimit të kontratave për operatorët me kapacitete të kufizuara profesionale dhe mungesë stafi, të cilat paraqesin probleme gjatë realizimit të kontratave dhe mund të pasojnë edhe me dështim në përmbushje të kontratave. Ndërsa mos shfrytëzimi i të drejtës për marrjen e dëmeve të likuiduara shpie në dëme financiare për Kompaninë.

Rekomandimi A28 Bordi i Drejtorëve të sigurojë se njësia e prokurimit, gjatë përgatitjes së dosjeve të tenderit, të përfshijë kërkesat esenciale të përshtatshmërisë teknike dhe profesionale të operatorëve ekonomik. Poashtu, të sigurojë që menaxherët e projekteve, ushtrojnë mbikëqyrje rigoroze gjatë zbatimit të kontratave, duke mundësuar që ato të realizohen brenda limitit kohor të përcaktuar.

Përgjigjja e menaxhmentit: Pajtohen.

Çështja A29: Mos publikimi i planifikimit final të prokurimit në ueb faqe të Kompanisë

Kriteri Rregullat dhe udhëzuesi operativ për prokurimin publik RRUOPP, pika 5.7. thekson se brenda 15 ditëve pas shpalljes së miratimit të buxhetit për vitin fiskal, secili autoritet kontraktues, i cili është autoritet publik ose ndërmarrje publike, do të përgatisë, do të publikoj në uebfaqen e Autoritetit përkatës Kontraktues dhe të njëjtin do të dorëzoj në Agjencinë Qendrore të Prokurimit Planifikimin Final të Prokurimit.

Gjetja Kompania nuk kishte publikuar planifikimin final të prokurimit për vitin 2019 në ueb faqen zyrtare të saj. Sipas pohimeve të zyrtarit të prokurimit, planifikimi final i prokurimit nuk ishte publikuar për shkak të mangësive në mirëmbajtjen e rregullt të uebfaqes.

Ndikimi Mos publikimi i planifikimit final të prokurimit zbehë transparencën ndaj publikut dhe përfituesve potencial rreth aktiviteteve zhvillimore të kompanisë. Gjithashtu, krijon kufizime të informacionit për operatorët ekonomik të interesuar për ofertim, varësisht nga kërkesat e kompanisë për plotësim të nevojave për punë/furnizime/shërbime.

Rekomandimi A29 Bordi i Drejtorëve të sigurojë se planifikimi final i prokurimit, publikohet në ueb faqen zyrtare të kompanisë, duke promovuar në këtë formë transparencë për aktivitetet zhvillimore të kompanisë.

Përgjigjja e menaxhmentit: Pajtohen.

Çështja A30: Mos emërimi i Zyrtarit Autorizues për iniciimin e aktiviteteve të prokurimit

Kriteri Ligji i Prokurimit Publik, nenet 22.1. dhe 22.2. specifikojnë se për çdo aktivitet të prokurimit të autoritetit kontraktues, Zyrtari Kryesor Administrativ duhet të caktojë një person që të shërbejë si Zyrtar Autorizues për atë aktivitet të prokurimit. Zyrtari Autorizues e autorizon iniciimin e aktivitetit të prokurimit.

Gjetja Kompania nuk kishte emëruar Zyrtar Autorizues për iniciim të aktiviteteve të prokurimit. Këtë rol e ushtronte Kryeshefi Ekzekutiv, i cili autorizonte iniciimin e të gjitha aktiviteteve të prokurimit.

Mos emërimi i Zyrtarit Autorizues ka ndodhur për shkak të dështimit të menaxhmentit për të vendosur kontrollet dhe pozitat e duhura në Kompani, sipas kërkesave të dispozitave ligjore.

Ndikimi Mungesa e Zyrtarit Autorizues paraqet mangësi në funksionimin e kontrollit të brendshëm gjatë ciklit të iniciimit të aktiviteteve të prokurimit.

Rekomandimi A30 Bordi i Drejtorëve të sigurojë se ekziston ndarje e duhur e detyrave dhe përgjegjësi, si dhe të ndërmarrë veprime adekuate për emërimin e Zyrtarit Autorizues, për të mundësuar forcimin e kontrolleve të brendshme dhe respektim të dispozitave ligjore të prokurimit publik.

Përgjigjja e menaxhmentit: Pajtohen.

Çështja A31: Mungesa e dëshmisë për procesin e ftesës për ofertë për procedurën me vlerë minimale

Kriteri Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik, neni 54, thekson se autoriteti kontraktues për procedurën me vlerë minimale duhet të kontaktojë së paku tre operator ekonomik, dhe është i obliguar të dokumentojë këtë proces nëpërmjet Regjistrit të Operatorëve Ekonomik të kontaktuar.

Gjetja Për aktivitetin “Furnizim me pajisje të teknologjisë informative për nevojat e kompanisë”, identifikua mungesë të regjistrit të operatorëve ekonomik të kontaktuar për procedurën me vlerë minimale, që do të dëshmonte procesin e ftesës për ofertë.

Sipas zyrtarit të prokurimit, nuk mund të jepet asnjë sqarim pse ka ndodhur kjo situatë.

Ndikimi Mungesa e regjistrit të operatorëve ekonomik të kontaktuar, për procedurën me vlerë minimale, paraqet mungesë transparence dhe konkurrimi efektiv gjatë përdorimit të fondeve të Kompanisë.

Rekomandimi A31 Bordi i Drejtorëve të sigurojë që njësia e prokurimit gjatë shfrytëzimit të procedurës me vlerë minimale për prokurim të mallrave/ shërbimeve/ punëve, procesi i ftesës për ofertim dëshmohet përmes regjistrit të operatorëve ekonomik të kontaktuar.

Përgjigjja e menaxhmentit: Pajtohen.

Njësia e Auditimit të Brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) operon me një Zyrtar të Auditimit. Për të kryer një auditim efektiv nevojitet një program gjithëpërfshirës i punës i cili reflekton rreziqet financiare dhe të tjera të Kompanisë dhe ofron siguri të mjaftueshme mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm. Ndikimi i produkteve të Auditimit të brendshëm duhet të gjykohet nga rëndësia që i jep Menaxhmenti zbatimit të rekomandimeve të auditimit.

NJAB kishte përgatitur planin vjetor ku kishte planifikuar tetë auditime. Prej tyre vetëm dy raporte kishin përfunduar gjatë vitit 2019. Komiteti i auditimit (KA) kishte dy mbajtur takime dhe kishte shqyrtuar raportet e NjAB-së.

Çështja A32: Mos realizimi i planit vjetor të auditimit të brendshëm

Kriteri	Sipas planit vjetor të Auditimit të Brendshëm, NjAB kishte planifikuar të kryej tetë auditime për vitin 2019.
Gjetja	<p>Auditimi i Brendshëm kishte një shkallë të ulët të realizimit të planit të auditimit, ku prej tetë raporteve të planifikuara kishte arritur t'i përfundoj vetëm dy apo 25% të raporteve të planifikuara.</p> <p>Kjo ka ndodhur si shkak i mos funksionimit efektiv të NjAB-së dhe mungesës së mbikëqyrjes nga Komitetit i Auditimit.</p>
Ndikimi	Mos realizimi i planit vjetor të NjAB-së zvogëlon sigurinë që i ofrohet menaxhmentit në lidhje me funksionimin e kontrolleve në ndërmarrje. Kjo mund të rezultojë me dobësi të paidentifikuara dhe me vazhdimin e praktikave joefektive që mund të rezultojnë me humbje financiare për ndërmarrjen.
Rekomandimi A32	Bordi i Drejtorëve të sigurojë përmbushjen e aktiviteteve të planifikuara të NjAB-së dhe monitorim efektiv nga Komiteti i Auditimit, në mënyrë që devijimet nga plani të adresohen në kohën e duhur. Poashtu, duhet të ndërmerret një rishikim për të adresuar shkaqet e mosrealizimit të planit vjetor.

Përgjigjja e menaxhmentit: Pajtohen.

Çështja A33: Mos hartimi i Politikave dhe procedurave të aktiviteteve të auditimit të brendshëm

Kriteri	Standardet Ndërkombëtare për Praktikën Profesionale të Auditimit të Brendshëm 2040, kërkojnë që Drejtuesi i auditimit të brendshëm të vendosë politika dhe procedura që shërbejnë si udhëzues për aktivitetin e auditimit të brendshëm.
Gjetja	Njësia e auditimit të brendshëm nuk ka politika dhe procedura të hartuara që rregullojnë procesin e auditimit të brendshëm. Kjo ka ndodhë si rezultat i mungesës së iniciativës nga kjo njësi.
Ndikimi	Në mungesë të këtyre politikave dhe procedurave, NJAB-së mund të bëjë anashkalime të praktikave profesionale të auditimit të brendshëm dhe rrjedhimisht të mos arrijë t'i shërbejë qëllimit për të cilin është formuar kjo njësi.
Rekomandimi A33	Bordi i Drejtorëve të sigurojë që janë ndërmarrë hapa konkret për hartimin e politikave dhe procedurave që udhëzojnë ushtrimin e aktiviteteve të AB-së.

Përgjigjja e menaxhmentit: Pajtohen.

Çështja A34: Mos funksionimi efektiv i komitetit të Auditimit

Kriteri	Sipas Udhëzuesit MF -Nr.01/2019 - për themelimin dhe funksionimin e komitetit të auditimit, kërkohet që takimet e Komitetit të Auditimit mbahen së paku katër herë në vit dhe ftohen nga kryesuesi i Komitetit të Auditimit. Takimi mbahet nëse shumica e anëtarëve të Komisionit të Auditimit marrin pjesë në takim.
Gjetja	Për vitin 2019, Komiteti i Auditimit nuk kishte funksionuar në mënyrë efektive përderisa kishte mbajtur vetëm dy takime. Kjo kishte ndodhur si shkak i interesimit jo të mjaftueshëm të Komitetit të Auditimit për të dhënë kontributin në përmirësimin e kontrolleve të brendshme, qeverisjen e mirë dhe menaxhimin e rrezikut në ndërmarrje
Ndikimi	Mos funksionimi efektiv i KA-së, rrit rrezikun e mungesës së funksionimit të kontrolleve të brendshme, qeverisjes së mirë dhe menaxhimit të rrezikut.
Rekomandimi A34	Bordi i Drejtorëve të sigurojë se Komiteti i Auditimit, funksionon në mënyrë efektive, jep kontributin e vet në qeverisjen e mirë, kontrollet e brendshme dhe menaxhimin e rrezikut, si dhe ka një bashkëpunim të ngushtë me NJAB-në.

Përgjigjja e menaxhmentit: Pajtohen.

3 Çështjet e zgjidhura gjatë ciklit të auditimit

Ne gjithashtu gjetëm çështje që iu komunikuan menaxhmentit dhe u zgjidhën në mënyrë efektive gjatë auditimit aktual. Ato nuk kërkojnë ndonjë veprim të mëtutjeshëm dhe raportohen vetëm me qëllim të dokumentimit të komunikimit në fjalë, veprimeve të ndërmarra dhe rezultateve të tyre. Këto ishin si më poshtë:

Çështja 1: Mos hartimi i Statutit të Auditimit të Brendshëm

Gjetja	NJAB nuk kishte hartuar Statutin e Auditimit të Brendshëm sipas kërkesave të standardit. Kjo ka ndodhur si rezultat i mungesës së vëmendjes nga komiteti i auditimit dhe njësia e auditimit të brendshëm për ta përgatitur këtë dokument formal.
Veprimi i kërkuar	Bordi i Drejtorëve në bashkëpunim me Komitetin e Auditimit të sigurojë hartimin e statutit të AB-së, duke përcaktuar qartë përmes këtij dokumenti formal (statutit): qëllimin, pozicionin, autoritetin dhe përgjegjësinë e aktiviteteve të auditimit të brendshëm në Kompani.
Rezultati	Statuti i AB është hartuar në dhjetor të vitit 2019 ndërsa është miratuar më 05.02.2020.

Çështja 2: Mos hartimi i planit strategjik dhe plani vjetor i auditimit jo i bazuar në rrezik

Gjetja	Njësia e auditimit të brendshëm kishte hartuar një plan vjetor ku kishte paraparë të kryej auditime, megjithatë ky plan nuk ishte i bazuar në rrezik. Për më tej, kjo njësi ende nuk kishte as plan strategjik të aprovuar.
Veprimi i kërkuar	Bordi i Drejtorëve të sigurojë që është hartuar plani strategjik dhe planet vjetore të auditimit bëhen bazuar në rrezik duke përfshirë objektivat, fushën, kohën dhe shpërndarjen e burimeve të angazhimit. Plani duhet të konsiderojë strategjinë e Kompanisë, objektivat dhe rreziqet e lidhura me angazhimin e administrimit të rrezikut.
Rezultati	Plani Strategjik është hartuar në tetor vitit 2019, ndërsa është miratuar më 19.02.2020.

Çështja 3: Raste të mungesës së evidencave për vijueshmëri në punë

Gjetja	Testet tona tregojnë se në dy raste punonjësit e ndërmarrjes, për muajin qershor dhe gusht, ishin nënshkruar vetëm në fillim të orarit të punës por jo edhe në përfundim të tij.
Veprimi i kërkuar	Bordi i Drejtorëve duhet të ndërmerr të gjitha veprimet për të siguruar se pagat paguhen për orët e realizuara të punës dhe se vijueshmëria e punonjësve në

punë monitorohet vazhdimisht ashtu siç parashihet me aktet nënligjore. Në raste të mungesave të paarsyeshme në punë të merren masa siç parashihet me rregulloret në fuqi.

Rezultati

Kompania ka paraparë masa shtesë sa i përket kontrollit në të ardhmen në mënyrë që të parandalohen lëshime të tilla. Poashtu, Ekipi i auditimit gjatë testimit të vijueshmërisë për muajt pasues nuk ka vërejtur lëshime të tilla.

Nënshkruar nga:



Besnik Osmani

Auditor i Përgjithshëm

Data: 18.06.2020

Zyra Kombëtare e Auditimit

Adresa: Rr. Ahmet Krasniqi, 210

Prishtinë, Kosovë

NAP/ Drejtori/UE




Arvita Zyferi



Fitim Haliti



Naim Neziri



KOMPANIA RAJONALE E UJËSJELLËSIT
REGIONAL WATER COMPANY
BIFURKACIONI ShA
Ferizaj



Tel. +383 (0) 290 320 650, Tel. & Fax. +383 (0) 290 321 119, e-mail: info@bifurkacioni.com, www.bifurkacioni.com

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2019
dhe për implementimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- Kam pranuar draft raportin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e Pasqyrave Financiare të KRU Bifurkacioni ShA, për vitin 2019 (në tekstin e mëtejshëm „Raporti”);
- Pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit, përveç çështjës A24;
- Brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t’ju dorëzoj një plan të veprimit për implementimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

Z. Burhan Salihu



Kryesues i Bordit të Drejtorëve,

Data: 16 qershor 2020, Ferizaj.

Shtojca I: Komentet e NP-së në gjetjet e raportit të auditimit

Nr. i komentit	Të gjeturat/ çështjet	Pajtohemi po/jo	Komentet e NP-së në rast të mospajtimit	Pikëpamjet e ZKA-së
1	Çështja 24: Shpërblimi me kontratë i Operatorëve Ekonomik të papërgjegjshëm	Jo Nuk pajtohen për pjesën e parë të gjetjes.	<p>Sipas interpretimit tonë, OE fitues është shpërblyer në përputhje me kushtet e parapara në dosjen e tenderit nr. 600-KRU Bifurkacioni Sha-19-2343-5-2-1 të datës 17.04.2019. Ne mendojmë se OE ka plotësuar tërësisht kërkesat e përshtatshmërisë profesionale dhe tekniko profesionale, duke përfshirë edhe pikat 9.1 dhe 9.2 ku flitet për kapacitetin teknik dhe profesional, për arsye në vijim:</p> <p>1) Sipas interpretimit tonë, teksti “Operatori Ekonomik duhet të ofroj dëshmi se ka realizuar me sukses, së paku 1(një) kontratë të natyrës së ngjashme (ndërtim të objekteve) në 3 (tre) vitet e fundit, në një vlerë prej jo më pak se 50,000 euro”, nuk e përjashton mundësinë që kjo vlerë të arrihet nga një e më shumë kontrata;</p> <p>2) Në këtë rast, kjo shumë është arritur përmes referencave të datës 25.04.2019 nr. prot VIII-97 dhe XVII-106, të lëshuar nga Komuna e Obiliqit – Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale në vlerë prej 20,981.30 euro dhe nga Drejtoria e Infrastrukturës Lokale në vlerë prej 31,639.84 euro.</p>	<p>Autoriteti Kontraktues (AK) “ Bifurkacioni” në Njoftimin për kontratë dhe Dosjen e Tenderit lidhur me lëndën e kontratës së lartcekur, në kuadër të kërkesave të përshtatshmërisë teknike dhe profesionale dhe dëshmisë së kërkuar, ka specifikuar si ne vijim :</p> <p>Operatori ekonomik (OE) duhet të ofroj dëshmi se ka realizuar me sukses, së paku 1(një) kontratë të natyrës së ngjashme (ndërtim të objekteve) në 3 (tre) vitet e fundit, në një vlerë prej jo më pak se 50,000.00 Euro, dhe si dëshmi, Operatori ekonomik duhet ta dorëzoj listën me kontrata të realizuara, nënshkruar dhe vulosura, duke ja bashkangjitur së paku 1 (një) letër referencë apo dëshmi të pranimit teknik. Mirëpo, OE fitues i kontratës nuk kishte dorëzuar dëshmi për realizimin me sukses të 1 (një) kontrate në vlerën e lartcekur (letër referencë apo dëshmi të pranimit teknik).</p> <p>Prandaj, interpretimi i “Bifurkacioni” i dt.11/06/2020 se “nuk e</p>

			<p>Duke u mbështetur në këtë që u tha më lartë, ne konsiderojmë se ky kriter është plotësuar.</p>	<p>përjashton mundësin që kjo vlerë të arrihet nga një e më shumë kontrata”, nuk qëndron pasi që nuk është specifikuar tek Njoftimi për kontratë dhe Dosja e Tenderit.</p> <p>Më tutje, gjetja qëndron, duke marrë për bazë se testet tona kanë rezultuar me mungesë të dëshmisë të kërkuara sipas dokumentacionit bazik të aktivitetit të prokurimit si: Njoftimi për kontratë dhe Dosja e Tenderit.</p>
--	--	--	---	---

Shtojca II: Statusi i zbatimit të rekomandimeve të vitit(eve) paraprak(e)

Auditimi i PFV-ve për vitin 2018 të KRU Bifrukacioni sh.a. është kryer nga një kompani private e auditimit. Raporti i auditimit ka rezultuar në katër rekomandime kryesore. KRU Bifrukacioni nuk kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqiten mënyra se si do t'i zbatonin rekomandimet e marra përveç komenteve në raportin e auditorit.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2019, një rekomandim ishte zbatuar pjesërisht dhe tre nuk ishin adresuar ende. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve)

Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve për vitin 2018 dhe vitin 2019

Nr.	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2018	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1	PFV	Rekomandojmë menaxhmentin të hartoj politika të përshtatshme kontabël në harmoni me standardet, ligjet dhe rregulloret në fuqi, si dhe kërkesave profesionale të menaxhmentit.	Sipas zyrtarëve përgjegjës në KRU Bifurkacioni, kompania është në proces të rishikimit të gjitha politikave dhe rregulloreve të kompanisë (financa, BNJ, të hyrat, pasuritë etj). të cilat duhet përditësuar pasi që janë të pa azhurnuara për një kohë të gjatë (2010,2007)	Rekomandim i pa zbatuar
2	Pasuritë	I rekomandoj menaxhmentit të kompanisë, duke analizuar kostot e një veprimi të tillë, që të bëjë rivlerësimin e aseteve, me qëllim të prezantimit të vlerës reale të tyre.	Sipas zyrtarëve përgjegjës, në momentin e përshtatshmërisë financiare, Kompania do të angazhojë kompani profesionale për rivlerësimin e të gjitha aseteve të Kompanisë.	Rekomandim i pa zbatuar

3	Inventarizimi i pasurisë dhe detyrimeve	I rekomandojmë menaxhmentit të kompanisë të hartoj udhëzimin për inventarizimin e pasurisë dhe detyrimeve. Po ashtu, zyrtarët e ngarkuar me evidenca kontabël, mos të emërohen në komisione për regjistrim, pasi që ata kanë detyrë nga pozita zyrtare lidhur me harmonizimin e regjistrimit fizik me evidenca kontabël të këtyre llogarive. Me rastin e zhvillimit të procesit të inventarizimit të pasurive dhe detyrimeve të kompanisë, rekomandojmë domosdoshmërisht zhvillimin e procedurave të harmonizimit të evidencave kontabël me raporte të komisioneve, me qëllim të konstatimit dhe rregullimit kontabël të tepricave dhe mungesave me datë 31 dhjetor 2018.	Çështja e përbërjes së komisioneve të inventarizimit duke pasur parasysh shmangien e konfliktit të interesit është adresuar. Ndërsa sa i përket udhëzuesit për inventarizim janë në proces të përgatitjes së Doracakut për Menaxhimin e pasurisë ku do të përfshihet edhe ky udhëzues ndërsa harmonizimi i raporteve të komisionit të inventarizimit të pasurisë me regjistrat kontabël nuk ka ndodhur as këtë vit për shkak të mungesës së barkodit (nr. identifikues) të aseteve dhe për këtë proces janë duke hulumtuar koston e blerjes së pajisjes për shtypjen e barkodeve	Rekomandim i pjesërisht i zbatuar për pjesën e komisioneve të inventarizimit ndërsa pjesa e përgatitjes së udhëzuesit është në proces të zbatimit.
4	Pozicionet e hapura të llogarive të caktuara në fund të periudhës	Rekomandojmë menaxhmentin e kompanisë që në kuadër të mundësive ta angazhojë një Zyrtar të llogarive të Arkëtueshme në kuadër të Departamentit të Financave, me ç'rast do të rriteshin mundësitë që këto llogari - pasuri qarkulluese të menaxhohen sipas standardeve dhe ligjeve në fuqi. Rekomandojmë menaxhmentin që në afate të caktuara ligjore periodike të aplikoj „letërkujtesat“ dhe letrat e „ekstraktit të pozicionit të hapur“ lidhur me pozitat e hapura të klientëve të kompanisë. Të njëjtin veprim ta bëjë edhe me rastin e marrjes së letrave të tilla nga furnitorët	Sipas zyrtarëve të Kompanisë, ende nuk është caktuar një zyrtar për llogari të arkëtueshme për arsye të vështirësive financiare, si dhe janë në proces të azhurnimit të rregulloreve ku do të futen edhe kërkesat për harmonizim periodik me furnitorët pasi që deri më tani nuk ka pasur një praktikë të tillë.	Rekomandim i pa zbatuar

		duke u përgjigjur në letrat e pranuar.		
Nr.	Fusha e auditimit	Rekomandimet e vitit 2019		
1	Baza për opinion	Bordi i Drejtorëve të sigurojë një rishikim gjithëpërfshirës të regjistrit të pasurisë dhe veprime konkrete përmirësuese në përputhje me kërkesat e SNK 16, për rivlerësimin dhe rishikimin e jetës së dobishme të pasurive.		
2	Baza për opinion	Bordi i Drejtorëve të sigurojë se janë marrë veprimet korrigjuese për shpenzimet e zhvlerësimit të pasurive në tërësi, si dhe një rishikim gjithëpërfshirës të regjistrit të pasurive në lidhje me vlerësimin për zgjatjen e jetës së dobishme apo heqjen nga regjistri për pasuritë me vlerë neto zero në libra.		
3	Baza për opinion	Bordi i Drejtorëve të sigurojë se janë marrë veprimet korrigjuese që të dhënat kontabël të jenë harmonizuar me gjendjen e borxheve ndaj Administratës Tatimore për llogaritë tatimore të TVSH-së si dhe për të gjitha llogaritë tjera tatimore.		
4	Baza për opinion	Bordi i Drejtorëve të sigurojë se janë marrë veprimet korrigjuese për prezantimin e saktë të detyrimit ndaj granteve dhe të ardhurave të shtyra në pasqyrat financiare dhe zbatimin e harmonizimeve periodike në mes të regjistrave kontabël për grantet me të ardhurat e shtyra.		
5	Baza për opinion	Bordi i Drejtorëve të sigurojë që janë marrë veprimet e nevojshme për t'i korrigjuar gabimet në lidhje me detyrimet në të dhënat kontabël në mënyrë që të bëhet një prezantim i saktë në pasqyrat financiare. Përveç kësaj, të krijohen mekanizma që regjistri i obligimeve të rishikohet në baza të rregullta kohore në mënyrë që të vërtetohet plotësia dhe saktësia e listës së detyrimeve ndaj furnitorëve.		
6	Baza për opinion	Bordi i Drejtorëve të sigurojë se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që janë bërë korrigjimet e gabimeve të identifikuara tek pasqyra e rrjedhës së parasë dhe pasqyra e ndryshimeve në ekuitet për ta siguruar një pamje të drejtë dhe të vërtetë të tyre.		
7	Baza për opinion	Bordi i Drejtorëve të sigurojë që shënimet shpjeguese të përmbajnë parimet bazë që përdoren për hartimin e pasqyrave financiare dhe informacionet mbi përbërjen e zërave të pasqyrave janë dhënë sipas kërkesave të standardeve të kontabilitetit		
8	Baza për opinion	Bordi i Drejtorëve të sigurojë se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet të cilat kanë ndikuar në modifikimin e opinionit. Po ashtu, të ndërmerren veprime për t'i adresuar shkaqet në mënyrë sistematike dhe për të hequr gabimet në pasqyrat financiare vjetore për ta siguruar një pamje të drejtë dhe të vërtetë të tyre. Pasqyrat financiare bazuar në udhëzuesin e KKRF dhe nënshkrimi i tyre nga KE dhe ZKFTH, duhet të bëhet vetëm pasi që janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme, para se të njëjtat t'i dorëzohen BD.		

9	PFV	Bordi i drejtorëve të sigurojë hartimin e udhëzuesit të politikave dhe procedurave kontabël dhe zbatimin e tij në mbajtjen e librave kontabël dhe raportim financiar.
10	Stoqet	Bordi i Drejtorëve të sigurojë që të bëhet matja e sasisë së naftës gjatë procesit të inventarizimit të stoqeve si dhe të bëhen korrigjimet e nevojshme kontabël për dëmtimet e stoqeve, për të siguruar saktësinë e vlerës së stoqeve të prezantuar në pasqyrat financiare.
11	Pasuritë	Bordi i Drejtorëve të sigurojë se janë marrë veprimet korrigjuese në lidhje me ndryshimet e nevojshme në regjistrin e pasurisë sipas gjendjes faktike të konstatuar dhe zbatimin e harmonizimeve periodike në mes të raporteve të komisioneve për inventarizim dhe vlerësim me regjistrin e pasurisë.
12	Të Hyrat	Bordi i Drejtorëve të sigurojë se janë vendosur ujëmatës në të gjitha qendrat e përpunimit dhe prodhimit të ujit, dhe përmes kësaj të konstatohet humbja e saktë e ujit në mënyrë që pastaj të mundësohet marrja e masave për shkaqet tjera të humbjeve të ujit.
13	Shpenzimet e Pagave	Bordi i Drejtorëve të sigurojë që rregulloret dhe Organogrami rishikohen në baza të rregullta dhe azhurnohen e plotësohen konform nevojave aktuale të ndërmarrjes.
14	Shpenzimet e Pagave	Bordi i Drejtorëve të sigurojë se rregulloret rishikohen në baza të rregullta dhe azhurnohen e plotësohen sipas nevojës, dhe pagesat e përvojës së punës të behën në harmoni me rregulloret e brendshme dhe legjislacionin e aplikueshëm në fuqi.
15	Shpenzimet e Pagave	Bordi i Drejtorëve të sigurojë që njoftimet dhe mënyra e njoftimeve lidhur me aplikuesit për punësim të jenë në harmoni me udhëzimet administrative që janë në fuqi.
16	Shpenzimet e Pagave	Bordi i Drejtorëve të sigurojë që vlerësimi i kandidatëve bëhet nga komisioni i përbërë prej tre anëtarëve, duke siguruar kështu proces transparent dhe të drejtë për të gjithë kandidatët.
17	Shpenzimet e Pagave	Bordi i Drejtorëve të sigurojë se ndarja e mjeteve financiare në emër të stimulimit të punonjësve të bëhet në përputhje me rregulloren kur Kompania ka fuqi financiare.
18	Shpenzimet e Pagave	Bordi i Drejtorëve të sigurojë që kompensimi për anëtarët e Bordit të bëhet në përputhje me kornizën ligjore dhe niveli i pagesave të jetë sipas Vendimit të Qeverisë për punën e kryer në Borde dhe Komisione.
19	Shpenzimet operative dhe shpenzimet tjera	Bordi i Drejtorëve të sigurojë se janë ndërmarrë veprime konkrete për definim me marrëveshje të statusit të pasurisë së Komunës të bartur në shfrytëzim tek Kompania, ku do të përcaktohej kohëzgjatja, të drejtat, obligimet dhe përgjegjësitë e palëve.
20	Shpenzimet operative dhe	Bordi i Drejtorëve të sigurojë një rishikim të strukturës organizative të stafit për plotësim të pozitës si dhe të sigurojë emërimin e zyrtarit certifikues, duke mundësuar forcim të kontrolleve të brendshme, parandalim të konflikteve të interesit dhe respektim të rregullave të Kontrollit dhe Menaxhimit Financiar para procedimit të pagesave.

	shpenzim et tjera	
21	Shpenzim et operative dhe shpenzim et tjera	Bordi i Drejtorëve të sigurojë hartimin e rregullores për menaxhimin e shpenzimeve ku do të përcaktohen qartë procedurat dhe kontrollet referuar standardeve, kërkesave të legjislacionit relevant në fuqi si dhe nevojave të organizimit të Kompanisë. Po ashtu, të sigurojë se të gjitha faturat e pranuarat të shpenzimeve, protokollohen në datën e pranimin të tyre, në mënyrë që të shmangen pagesat e dyfishta dhe të menaxhohen me kohë obligimet e ndërmarrjes.
22	Shpenzim et operative dhe shpenzim et tjera	Bordi i Drejtorëve të sigurojë një planifikim të drejtë dhe të saktë duke evituar çfarëdo ndarje të aktiviteteve të njëjta të prokurimit ashtu që sigurohet blerje efikase, dhe mundësohet në këtë formë respektimi i kërkesave ligjore për paranë e shpenzuar.
23	Shpenzim et operative dhe shpenzim et tjera	Bordi i Drejtorëve të sigurojë se Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit ushtron mbikëqyrje efektive ndaj komisioneve të vlerësimit në mënyrë që të evitohen rastet e vonesave për fillim të vlerësimit të tenderëve.
24	Shpenzim et operative dhe shpenzim et tjera	Bordi i Drejtorëve të sigurojë se Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit ushtron mbikëqyrje ndaj komisioneve të vlerësimit në mënyrë që të evitohen rastet e shpërbllimit me kontratë të operatorëve ekonomik, ofertat e të cilëve nuk janë në pajtueshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit.
25	Shpenzim et operative dhe shpenzim et tjera	Bordi i Drejtorëve të sigurojë që për çdo kontratë të prokurimit të nënshkruar të hartohet plani i menaxhimit të kontratave në mënyrë që të monitorohen dhe të raportohet progresi i zbatimit të tyre.
26	Shpenzim et operative dhe shpenzim et tjera	Bordi i Drejtorëve të sigurojë se Njësia e Prokurimit me rastin e nënshkrimit të kontratave, merr masat e nevojshme që dokumenti i Identifikimit Financiar Bankar i plotësuar nga Operatorët Ekonomik me shënimet e llogarive të tyre bankare, i bashkëngjitet kontratës, duke siguruar në këtë formë që transferet e pagesave për shërbimet e pranuarat bëhen në llogari bankare të autorizuar.
27	Shpenzim et operative dhe shpenzim et tjera	Bordi i Drejtorëve të sigurojë se njësia e prokurimit dhe njësitë kërkuese koordinohen gjatë hartimit të "Planit Përfundimtar Vjetor të Prokurimit", duke mundësuar përgatitjen e një plani të detajuar për secilin produkt, shërbim, punë si dhe të eliminohet çfarëdo nevojë për prokurime jashtë planit.
28	Shpenzim et	Bordi i Drejtorëve të sigurojë se njësia e prokurimit gjatë përgatitjes së dosjeve të tenderit të përfshijë kërkesat esenciale të përshtatshmerisë teknike dhe

	operative dhe shpenzim et tjera	profesionale të operatorëve ekonomik. Poashtu, të sigurojë që menaxherët e projekteve ushtrojnë mbikëqyrje rigoroze gjatë zbatimit të kontratave, duke mundësuar që ato të realizohen brenda limitit kohor të përcaktuar
29	Shpenzim et operative dhe shpenzim et tjera	Bordi i Drejtorëve të sigurojë se planifikimi final i prokurimit publikohet në ueb faqen zyrtare të kompanisë, duke promovuar në këtë formë transparencë për aktivitetet zhvillimore të kompanisë.
30	Shpenzim et operative dhe shpenzim et tjera	Bordi i Drejtorëve të sigurojë se ekziston ndarje e duhur e detyrave dhe përgjegjësive si dhe të ndër marrë veprime adekuate për emërimin e Zyrtarit Autorizues, për të mundësuar forcimin e kontroleve të brendshme dhe respektim të dispozitave ligjore të prokurimit publik.
31	Shpenzim et operative dhe shpenzim et tjera	Bordi i Drejtorëve të sigurojë që njësia e prokurimit gjatë shfrytëzimit të procedurës me vlerë minimale për prokurim të mallrave/ shërbimeve/ punëve, procesi i ftesës për ofertim dëshmohej përmes regjistrimit të operatorëve ekonomik të kontaktuar.
32	Auditimi i Brendshëm	Bordi i Drejtorëve të sigurojë përmbushjen e aktiviteteve të planifikuara të NJAB-së dhe monitorim efektiv nga Komiteti i Auditimit në mënyrë që devijimet nga plani të adresohen në kohën e duhur. Poashtu duhet të ndërmerret një rishikim për të adresuar shkaqet se pse nuk është arritur realizimi i planit vjetor.
33	Auditimi i Brendshëm	Bordi i Drejtorëve të sigurojë që janë ndër marr hapa konkret për hartimin e politikave dhe procedurave që udhëzojnë ushtrimin e aktiviteteve të AB-së.
34	Auditimi i Brendshëm	Bordi i Drejtorëve të sigurojë se Komiteti i Auditimit funksionon në mënyrë efektive, jep kontributin e vet në qeverisjen e mirë, kontrollet e brendshme dhe menaxhimin e rrezikut si dhe ka një bashkëpunim të ngushtë duke e mbështetur NJAB-në.

Shtojca III: Pasqyrat Financiare Vjetore të Audituarra



KOMPANIA RAJONALE E UJËSJELLËSIT
REGIONAL WATER COMPANY
BIFURKACIONI ShA
Ferizaj

Tel. +383 (0) 290 320 650, Tel & Fax. +383 (0) 290 321 119, e-mail: info@bifurkacioni.com, www.bifurkacioni.com

PASQYRAT FINANCIARE 2019



Ferizaj

Përmbajtja:

I. Bilanci i gjendjes	3
II. Pasqyra e të ardhurave.....	4
III. Pasqyra e rrjedhjes së parasë se gatshme.....	5
IV. Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet.....	6
V. Politikat kontabël dhe shënimet shpjeguese në pasqyrat financiare	7

Bilanci i gjendjes së KRU Bifurkacioni ShA Ferizaj më 31.12.2019

Pasqyra e pozitës financiare
më 31 dhjetor 2019

	shënimi	31.12.2019	31.12.2018
		€	€
PASURITË			
Pasuritë afatshkurta			
Paraja dhe ekuivalentët e parasë		369,088.8	246,166.2
Llogaritë e arkëtueshme		5,260,123.6	4,922,560.9
Parapagimet / avanset e paguara		1,354.6	1,645.0
Kërkesat nga ATK - tatimi		-	-
Stoqet		190,441.3	192,587.8
Pasuritë tjera		-	-
Gjithsej pasuritë afatshkurtra		5,821,008.3	5,362,959.9
Pasuritë afatgjata			
Prona, paisjet dhe impiantet		7,988,059.5	8,793,325.6
Investimet ne vijim			
Pasuritë tjera afatgjate			
Gjithsej pasuritë afatgjata		7,988,059.5	8,793,325.6
GJITHSEJ PASURITË		13,809,067.7	14,156,285.6
DETYRIMET DHE EKUITETI			
DETYRIMET			
Detyrimet afatshkurta			
Mibitërheqja bankare		-	-
Llogaritë e pagueshme		110,583.0	133,555.3
Kreditë dhe huatë, pjesa afatshkurtër		-	-
Interesi i pagueshëm		-	-
Tatimi në fitim, i pagueshëm		-	-
Tatime te tjera të pagueshme		410,793.3	420,998.4
Detyrimet ndaj lizingut, pjesa afatshkurtër		-	-
Detyrime tjera afatshkurte		-	-
Gjithsej detyrimet afatshkurta		521,376.4	554,553.7
Detyrimet afatgjata			
Kreditë dhe huatë, pjesa afatgjate		-	-
Detyrimet ndaj lizingut, pjesa afatgjata		-	-
Detyrime tjera afatgjata		5,076,691.1	5,343,885.4
Gjithsejt detyrimet afatgjata		5,076,691.1	5,343,885.4
GJITHSEJ DETYRIMET		5,598,067.5	5,898,439.1
EKUITETI			
Kapitali aksionar		25,000.0	25,000.0
Fitimet e mbajtura		(2,405,891.1)	(2,448,027.5)
Fitimi apo humbja e vitit afarist		(50,511.5)	38,329.9
Rezervat e tjera		10,642,544.6	10,642,544.6
GJITHSEJ EKUITETI		8,211,142.0	8,257,847.0
GJITHSEJ EKUITETI DHE DETYRIMET		13,809,209.4	14,156,286.1

Zyrtari Kryesor i Financave

Valon Sadiku

Kryeshefi Ekzekutiv

Xhabir Morina

II

Pasqyra e të ardhurave për periudhën 01.01.2019 deri 31.12.2019

Paqsyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse
për vitin që përfundon më 31.12.2019

shenimi	31.12.2019	31.12.2018
	€	€
Të hyrat	2,341,744.0	2,444,454.0
Kosotoja e shitjes	(42,853.2)	(38,657.2)
Fitimi / humbja bruto	2,298,890.8	2,405,796.8
Të ardhura tjera		
Shpenzimet operative	(232,480.0)	(263,076.0)
Shpenzimet administrative	(63,933.4)	(78,882.9)
Shpenzimet e personelit	(1,229,590.3)	(1,212,950.6)
Shpenzimet e zhvlerësimit	(879,387.0)	(881,728.8)
Shpenzime tjera	(4,376.4)	(34,282.4)
Fitimi / Humbja operative	(2,409,767.1)	(2,470,920.6)
Të ardhura financiare	60,364.8	103,454.0
Shpenzime financiare	-	-
Fitimi / humbja para tatimit	(50,511.5)	38,330.1
Shpenzimet e tatimit në fitim	-	-
Fitimi / humbja e vitit	(50,511.5)	38,330.1

Zyrtari Kryesor i Financave

Valon Sadiku

Kryeshefi Ekzekutiv

Xhabir Morina

III

Pasqyra e rrjedhjes së parasë se gatshme për vitin që përfundon më 31.12.2019

Pasqyra e rrjedhjes së parasë së gatshme
për vitin që përfundon më 31.12.2019

shënimi	31.12.2019 €	31.12.2018 €
Rrjedha e parasë nga aktivitetet operative		
Fitimi / (humbja) e vitit	(50,511.5)	38,330.1
Zhvlërësimi i pronës, paisjeve dhe impianteve	879,387.0	881,728.8
Të ardhurat financiare		
Shpenzimet financiare		
Fitimi / (humbja) nga shitja e pronës		
Shpenzimet e tatimit në fitim		
(Rritja) / zvogëlimi në llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera	(277,086.8)	(469,415.6)
(Rritja) / zvogëlimi në stoqe	2,146.5	7,311.0
(Rritja) / zvogëlimi në pasuritë tjera	(60,185.1)	(102,657.9)
Rritja / (zvogëlimi) në llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera	(19,307.9)	(27,926.7)
Rritja / (zvogëlimi) në detyrime të tjera	(10,205.1)	(50,502.1)
Tatimi në fitim i paguar	-	-
Interesi i paguar	-	-
Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet operative	464,237.2	276,867.7
Rrjedha e parasë nga Aktivitetet Investuese		
Pagesat për blerjen e pronës, paisjeve dhe impianteve	(74,120.9)	(13,477.4)
Arkëtimet nga shitja e pronës, paisjeve dhe impianteve	-	-
Pagesat për blerjen e e pasurive të paprekshme	-	-
Interesi I arkëtuar	-	-
Dividendat e arkëtuara	-	-
Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet investuese	(74,120.9)	(13,477.4)
Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet financuese		
Deponimet e kapitalit shtesë		
Dividendat e paguara		
Arkëtimet nga kreditë dhe huatë		
Ripagimi i kredive dhe huave		
Pagesat e lizingut financiar	(267,194.3)	(294,738.7)
Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet financuese	(267,194.3)	(294,738.7)
Rrjedha / (zvogëlimi) neto i parasë dhe ekuivalentëve të parasë	122,922.0	(31,348.5)
Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fillim të vitit	246,166.7	277,515.2
Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fund të vitit	369,088.7	246,166.7

Zyrtari Kryesor i Financave

Valon Sadiku

Kryeshefi Ekzekutiv


Xhabir Morina


IV

Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet për vitin që përfundon më 31.12.2019

Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet
për vitin që përfundon më 31.12.2019

	Kapitali aksionar	Fitimet e mbajtura	Rezervat tjera	Gjithsejt
Gjendja më 1 janar 2018	25,000.0	(2,448,027.5)		(2,423,027.5)
Fitimi / humbja e vitit		38,329.9		38,329.9
Dividendat		-		-
Deponimet shtesë		-		-
Ndarja e rezervave		10,642,544.6		10,642,544.6
Gjendja me 31 dhjetor 2018	25,000.0	8,232,847.0		8,257,847.0
Gjendja më 1 janar 2019	25,000.0	(2,405,891.1)		(2,380,891.1)
Fitimi / humbja e vitit		(50,511.5)		(50,511.5)
Dividendat		-		-
Deponimet shtesë		-		-
Ndarja e rezervave		10,642,544.6		10,642,544.6
Gjendja me 31 dhjetor 2019				8,211,142.0

Zyrtari Kryesor i Financave

Valon Sadiku

Kryeshefi Ekzekutiv

Xhabir Morina

V

Politikat kontabël dhe shënimet shpjeguese në pasqyrat financiare për vitin 2019

1. Informata të përgjithshme

KRU Bifurkacioni ShA është ndërmarrje publike për ofrimin e shërbimeve të furnizimit me ujë të pijshëm dhe grumbullimit të ujërave të ndotura.

Paraardhësia e kësaj kompanie është themeluar në vitin 1952 si ndërmarrje për grumbullimin e mbeturinave. Në vitin 1961 është përruruar Fabrika e Trajtimit të Ujit në Pleshinë, e cila në vitin 1966 është marrë nën menaxhim nga kjo ndërmarrje, nën statusin e ndërmarrjes shoqërore-shtetërore me emërtimin ZVEZDA (në gjuhën shqipe YLLI). Këtë emërtim e ka mbajtur deri në vitin 1999 kur transformohet në ndërmarrje publike për ofrimin e shërbimeve të ujësjellësit, kanalizimit dhe grumbullimit të mbeturinave nën menaxhimin e Shtyllës së IV të Misionit të Kombeve të Bashkuara për Administrimin e Kosovës (UNMIK), si Ndërmarrje Komunale Publike e emërtuar si Organizata Shoqërore Publike (OSHP) HIDRO-HIGJIENA.

Në nëntor të vitit 2003, OSHP HIDRO-HIGJIENA ndahet në dy kompani të reja dhe të pavarura publike: në kompaninë publike Kompania Rajonale për Ujësjellës dhe Kanalizim (KRUK) BIFURKACIONI, e cila merret vetëm me shërbimet e ujësjellësit dhe kanalizimit dhe në kompaninë tjetër publike Ndërmarrja Publike Rajonale për Mbeturina (NPRM) PASTËRTIA, e cila merret me mirëmbajtjen e pastërtisë dhe grumbullimin e mbeturinave. Në pjesën e parë të vitit 2004, KRUK BIFURKACIONI regjistrohet nga Qeveria e Kosovës, respektivisht nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (Vendimi i KRUK BIFURKACIONI Nr. 793 i datës 17.09.2004).

Me vendim të Qeverisë së Kosovës, gjegjësisht Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, më 31 Maj të vitit 2007 KRUK Bifurkacioni Ndërmarrje Publike (NP) transformohet në Shoqëri Aksionare (ShA) të Komunës së Ferizajt me 85.30% të aksioneve dhe të Komunës së Kaçanikut me 14.70% të aksioneve, duke u riemërtuar si KRUK BIFURKACIONI ShA. Deri në 31 Qershor 2008, kjo kompani është mbikëqyrur nga Agjencioni Kosovar i Mirëbesimit, ndërsa pas kësaj date mbikëqyret nga Komunitat e Ferizajt dhe Kaçanikut.

Në Mars 2009, në mënyrë të njëanshme dhe të kundërligjshme u pavarësua njësia e Kaçanikut, duke u ndarë nga KRUK BIFURKACIONI dhe duke u emërtuar si LYPETENI, ndërsa ribashkimi është bërë në Janar 2015.

Me kërkesën e Zyrës Rregullatore për Ujësjellës dhe Kanalizim (tash Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit) dhe duke u bazuar në Ligjin Nr. 04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L 087 për Ndërmarrjet Publike, në mbledhjen e Bordit të Drejtorëve të datës 16.04.2014 merret vendim për ndryshimin e emërtimit të kompanisë nga KRUK Bifurkacioni në KRU Bifurkacioni ShA (KRU-B).

KRU-B posedon licencën për kryerjen e veprimtarisë së saj, të lëshuar më 25.09.2018, me numër L-06/2018, nga Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit (ARRU) për periudhën 2018-2026.

Vlerat kryesore të kompanisë janë përkushtimi për ofrimin e shërbimeve cilësore ndaj konsumatorëve, arritja e vetëqëndrueshmërisë financiare dhe të qenit transparent ndaj akterëve relevant të sektorit të ujit në Kosovë.

Kompania është e rexhistruar me numër unik identifikues 810663353, numër fiskal 600027892, numrit të regjistrimit të biznesit:70433592 dhe çertifikatën e TVSH-ës me numër: 330035859. Adresa e zyrës qendrore është rruga "Enver Topalli" nr.45 në Ferizaj.

Kapitali fillestar i regjistruar i Kompanisë është 25,000.00 Euro. Kompania Regjionale e Ujit dhe Kanalizimit Bifurkacioni ShA. Ferizaj ka edhe njësit e saja: Njësia Operative "Bifurkacioni" në Kaçanik dhe Zyra e Shërbimeve në Han te Elezit.

Bazat e përgatitjes dhe politikat kontabël

Pasqyra financiare është raport financiar për qëllime të përgjithshme i cili përgatitet në pajtueshmëri me ligjet dhe rregulloret në fuqi në Kosovë, me Standardet e Kontabilitetit dhe në harmoni me kërkesat e Bordit për Raportime Financiare të Kosovës, si dhe për nevoja të Menaxhmentit dhe shfrytëzuesve tjerë. Pasqyrat financiare janë përgatitur në pajtim me kostot historike të pasurive dhe detyrimeve për çka ka dëshmi të mjaftueshme."

Njohja e të hyrave

Të hyrat nga shitja e mallrave njihen kur mallrat janë dorëzuar dhe pronësia është bartur.

Kostot e huamarrjes

Të gjitha kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave në periudhën në të cilën kanë ndodhur.

Tatimi në fitim

Tatimi në fitim paraqet shumën e tatimit të pagueshëm aktual dhe të tatimin e shtyrë. Tatimi i pagueshëm aktual është i bazuar në fitimin e tatueshëm të vitit.

Tatimi i shtyrë njihet nga diferencat ndërmjet vlerës kontabël të asetëve dhe detyrimeve në pasqyrat financiare dhe bazat e tyre përkatëse tatimore (të njohura si diferencat e përkohshme). Detyrimet e shtyra tatimore njihen për të gjitha diferencat e përkohshme të cilat pritet të rrisin fitimin e tatueshëm në të ardhmen. Pasuritë e shtyra tatimore njihen për të gjitha diferencat e përkohshme të cilat pritet të zvogëlojnë fitimin e tatueshëm në të ardhmen dhe çdo humbje tatimore ose kreditim tatimor të papërdorur. Pasuritë e shtyra tatimore maten me shumën më të lartë që, në bazë të fitimit të tatueshëm të tanishëm ose të ardhshëm të vlerësuar, ka më shumë gjasa që të rimerret sesa që të mos rimerret.

Vlera kontabël neto e pasurive të shtyra tatimore rishikohet në çdo datë të raportimit dhe rregullohet për të pasqyruar vlerësimin aktual të fitimeve të tatueshme në të ardhmen. Çdo rregullim njihet në fitim ose humbje.

Tatimi i shtyrë është llogaritur duke përdorur normën tatimore që pritet të zbatohet në fitimin e tatueshëm (humbjen e tatueshme) të periudhave në të cilat tatimi i shtyrë si aset pritet që të realizohet ose detyrimet e shtyra tatimore që të zgjidhen, në bazë të normave tatimore që janë në fuqi ose që do të jenë në fuqi deri në fund të periudhës raportuese.

Prona, pajisjet dhe impiantet

Prona, pajisjet dhe impiantet janë matur me kosto minus zhvlerësimi i akumuluar dhe çdo humbje e akumuluar nga dëmtimi (rënia në vlerë).

Zhvlerësimi ngarkohet në mënyrë që të ndahet kosto e pasurive minus vlera e tyre e mbetur përgjatë jetës së përdorimit të parashikuar, duke përdorur metodën lineare. Normat vjetore të mëposhtme janë përdorur për zhvlerësimin e pronës, impianteve dhe pajisjeve:

Pajisjet e zyrës, veturat	20 %
Ndërtesat, rrjeti i ujësjellësit dhe kanalizimit	5 %

Nëse ka një tregues se ka pasur një ndryshim të rëndësishëm në normën e zhvlerësimit, jetën e dobishme ose vlerën e mbetur të një pasurie, zhvlerësimi i kësaj pasurie rishikohet në mënyrë prospektive për të pasqyruar pritshmëritë e reja.

Pasuritë e paprekshme

Pasuritë e të paprekshme janë softueri kompjuterik i blerë që njihet me koston minus amortizimin e akumuluar dhe çdo humbje të akumuluar nga dëmtimi (rënia në vlerë). Amortizohen gjatë jetës së tyre të llogaritur prej 5 vjetësh duke përdorur metodën lineare. Nëse ka një tregues se ka pasur një ndryshim të rëndësishëm në normën e amortizimit, jetës së dobishme ose vlerës së mbetur të një pasurie të paprekshme, amortizimi rishikohet në mënyrë prospektive për të pasqyruar pritshmëritë e reja.

Dëmtimi (rënia në vlerë) i pasurive

Në çdo datë të raportimit, prona, pajisjet dhe impiantet, pasuritë e tjera të paprekshme dhe investimet në pjesëmarrje rishikohen për të përcaktuar nëse ka ndonjë tregues se këto pasuri kanë pësuar ndonjë dëmtim, përkatësisht ndonjë humbje nga rënia në vlerë. Nëse ka një tregues për rënie të mundshme, shuma e rikuperueshme e çdo pasurie të prekur (ose grup pasurish të ngjashme) vlerësohet dhe krahasohet me vlerën e saj kontabël. Në qoftë se shuma e vlerësuar e rikuperueshme është më e ulët, vlera kontabël ulet deri në shumën që vlerësohet se do të merret, ndërsa shuma e dëmtimit (humbja nga rënia në vlerë) njihet menjëherë në pasqyrën e të ardhurave.

Në mënyrë të ngjashme, në çdo datë të raportimit, stoqet vlerësohen për rënie të vlerës duke krahasuar vlerën kontabël neto të çdo artikulli të stoqeve (ose grupit të artikujve të ngjashëm) me çmimin e tij të shitjes minus kostot e shitjes. Nëse një artikull i stoqeve (ose grupi i artikujve të ngjashme) është i dëmtuar, vlera e tij kontabël reduktohet për çmimin shitës minus kostot e shitjes, dhe humbja nga rënia në vlerë njihet menjëherë në pasqyrën e të ardhurave.

Në qoftë se dëmtimi (humbja nga rënia në vlerë) më pas kthehet, vlera kontabël e pasurisë (ose grup pasurish të ngjashme) rritet për vlerësimin e rishikuar të shumës së tij të rikuperueshme (çmimi shitës minus kostot e shitjes, në rastin e stoqeve), por jo në tejkalimin e shumës që do të ishte përcaktuar nëse nuk do ishte njohur asnjë humbje nga rënia në vlerë për pasurinë (grup pasurish të ngjashme) në vitet e mëparshme. Një anulim i një humbjeje nga rënia në vlerë njihet menjëherë në pasqyrën e të ardhurave.

Stoqet

Stoqet janë prezantuar me vlerën më të ulët ndërmjet koston dhe çmimit të shitjes minus kostot e kompletimit dhe shitjes. Kosto e stoqeve të shitura është llogaritur duke përdorur metodën e koston mesatare.

Llogaritë e arkëtueshme

Shitjet janë bërë në bazë të afateve normale të kreditimit, si dhe llogaritë e arkëtueshme nuk bartin interes, në fund të vitit fiskal llogaritë e arkëtueshme nuk janë provizionuar. Në fund të çdo periudhe raportuese, vlerat kontabël të llogarive të arkëtueshme tregtare dhe të tjera shqyrtohen.

Llogaritë e pagueshme

Llogaritë e pagueshme tregtare janë detyrime në bazë të afateve normale të kreditimit dhe nuk bartin interes. Të pagueshmet tregtare të shprehura në monedhë të huaj shprehen në valutën Euro duke përdorur kursin e këmbimit në datën e raportimit. Fitimet ose humbjet e këmbimit valutë janë të përfshira në të ardhurat e tjera apo shpenzimet e tjera.

PASURITË	2019	2020
Pasuritë afatshkurtra		
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	369,088.8	246,166.2
Llogaritë e arkëtueshme	5,260,123.6	4,922,560.9
Parapagimet /avanset e paguara	1,354.6	1,645.0
Kërkesat nga ATK - tatimi		
Stoqet	190,441.3	192,587.8
Pasuritë tjera		
Gjithsej pasuritë afatshkurtra	5,821,008.3	5,362,959.9
Pasuritë afatgjata		
Prona , paisjet dhe impiantet	7,988,059.5	8,793,325.6
Investimet ne vijim		
Pasuritë tjera afatgjate		
Gjithsejt pasuritë afatgjata	7,988,059.5	8,793,325.6
GJITHSEJ PASURITË	13,809,067.7	14,156,285.6
Detyrimet afatshkurtra	2019	2020
Mibitërheqja bankare		
Llogaritë e pagueshme	110,583.0	133,555.3
Kreditë dhe huatë , pjesa afashk.		
Interesi I pagueshëm		
Tatimi në fitim , I pagueshëm		
Tatime te tjera të pagueshme	410,793.3	420,998.4
Detyrimet ndaj lizingut , pjesa afatshk.		
Detyrime tjera afatshkurte		
Gjithsejt detyrimet afatshkurtra	521,376.4	554,553.7
Detyrimet afatgjata		
Kreditë dhe huatë , pjesa afatgjate		
Detyrimet ndaj lizingut , pjesa afatgjate		
Detyrime tjera afatgjate	5,076,691.1	5,343,885.4
Gjithsejt detyrimet afatgjata	5,076,691.1	5,343,885.4
GJITHSEJT DETYRIMET	5,598,067.5	5,898,439.1
Të hyrat	2019	2018
Te hyrat nga shitja e ujit	1,248,380.02	1,337,966.09
Te hyrat nga ujrat e zeza	409,312.88	430,394.44
Te hyrat nga tarifat fikse	385,831.77	361,146.16
Te hyrat nga sherbimet tjera	31,025.39	33,690.16
Te hyrat nga grantet (Te hyrat e Shtyera)	267,194.26	281,257.13
Gjithsej të hyra	2,341,744.32	2,444,453.98

Shpenzimet Operative

Përshkrimi	2019	2018
Shpenzimet e pagave	(1,229,590.30)	(1,212,950.64)
Shpenzimet e energjise	(147,868.69)	(143,816.97)
Shpenzimet administrative	(63,933.38)	(78,882.88)
Shpenzimet e mirembajtjes dhe riparimit	(52,491.53)	(85,708.48)
Shpenzimet e derivateve- lendeve djegese	(30,275.37)	(31,418.55)
Shpenzimet e marketingut	(1,844.43)	(2,131.95)
Shpenzimet tjera	(4,376.37)	(34,282.36)
Gjithsej shpenzimet operative	(1,530,380)	(1,589,192)
Shpenzimet e amortizimit	(879,387.03)	(881,728.81)
Gjithsejt shpenzimet	(2,409,767.10)	2,470,920.64)